Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

2017/III

RAPORTI I REFEROHET DEKLARATËS SË POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2017, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 37, DATË 2.08.2017

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 270 kopje
Shtypur nga Botimet IDEA *sh.p.k.*

P Ë R M B A J T J A

OBJEKTIVI 7

1. FJALA E GUVERNATORIT 9

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË 12

3. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË 15

3.1. Ekonomia botërore 15
3.2. Ecuria e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet botërore 19
3.3. Tregjet financiare 20

4. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE 22

4.1. Zhvillimet në tregjet financiare 22
4.2. Normat e interesit të depozitave dhe kredive dhe kushtet e financimit 25
4.3. Kreditimi i sektorit privat 27
4.4. Financimi i sektorit publik 29
4.5. Ecuria e depozitave dhe e parasë në ekonomi 30

5. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE 33

5.1. Ecuria e inflacionit 33
5.2. Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate 35
5.3. Gjendja ciklike e ekonomisë dhe presionet e brendshme inflacioniste 50
5.4. Inflacioni i importuar 52
5.5. Pritjet për inflacionin 56

SHTOJCA STATISTIKORE 58

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1: Ecuria e çmimeve në tregun e banesave 43
Hapësirë informuese 2: Zhvillimet në bilancin e pagesave në tremujorin e parë të vitit 2017 49
Hapësirë informuese 3: Ndikimi i mbiçmimit të kursit të këmbimit në inflacion 54

PËRMBAJTJA E TABELAVE

3. Ambienti i jashtëm i ekonomisë
Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë 16
Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet fqinje 19

5. Inflacioni dhe rritja ekonomike
Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor 35
Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave 49

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

2. Stabiliteti i çmimeve dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë

Grafik 1. Normat e interesit në monedhën vendase 14
Grafik 2. Treguesi i përbërë paraprijës i PBB-së (CLI) dhe Prodhimi Industrial i vendeve kryesore dhe inflacioni 15

3. Ambienti i jashtëm i ekonomisë

Grafik 3. Indeksi i përbërë i prodhimit (PMI), PBB-ja tremujore dhe treguesi i ndjesisë ekonomike dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin dhe konsumatorët 17
Grafik 4. Ndryshimet vjetore të çmimeve të mallrave bazë 19
Grafik 5. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore 20
Grafik 6. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 20
Grafik 7. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar 22

4. Tregjet financiare dhe zhvillimet monetare

Grafik 8. Ecuria e kursit efektiv të këmbimit dhe e monedhave individuale të shportës 23
Grafik 9. Ecuria e kursit efektiv të këmbimit dhe e monedhave individuale të shportës 24
Grafik 10. Yield-et në tregun primar 25
Grafik 11. Normat e interesit për depozitat e reja 26
Grafik 12. Normat e interesit për kredinë e re, mesatare rrëshqitëse 6-mujore 27
Grafik 13. Kushtet e kreditimit 28
Grafik 14. Kredia për sektorin privat sipas monedhës dhe agjentëve ekonomikë 29
Grafik 15. Kredia sipas agjentëve ekonomikë dhe qëllimit të përdorimit 30
Grafik 16. Deficiti buxhetor dhe financimi i tij dhe mbajtësit e borxhit të brendshëm 30
Grafik 17. Ecuria e treguesve monetarë 31
Grafik 18. Ecuria e depozitave në sistemin bankar sipas monedhës dhe agjentëve ekonomikë 32
Grafik 19. Inflacioni vjetor dhe objektivi. Inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE 33

5. Inflacioni dhe rritja ekonomike

Grafik 20. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total 34
Grafik 21. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit 36
Grafik 22. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve 37
Grafik 23. Ecuria e vlerës së shtuar në ndërtim dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve 37
Grafik 24. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve 38
Grafik 25. Treguesi i ndjesisë ekonomike dhe struktura e kërkesës së brendshme 40
Grafik 26. Ecuria e konsumit privat dhe e indeksit të besimit konsumator 40
Grafik 27. Tregues të tërthortë sasiorë dhe cilësorë për ecurinë e konsumit privat 41
Grafik 28. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore 41
Grafik 29. Tregues afatshkurtër të investimeve për tremujorin e parë 42
Grafik 30. Indeksi i çmimit dhe i qirasë së banesave dhe raporti i tyre 43
Grafik 31. Orientimi i politikës fiskale 44
Grafik 32. Ecuria e shpenzimeve 44
Grafik 33. Ecuria e të ardhurave buxhetore 45
Grafik 34. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate 46
Grafik 35. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive 46
Grafik 36. Ecuria vjetore e çmimit të naftës në tregun Brent, e eksportit të naftës vendase, e indeksit të çmimit të metaleve dhe e eksportit të metaleve vendase 47
Grafik 37. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë 50
Grafik 38. Ndryshimet vjetore mesatare të sheshuara të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit 51
Grafik 39. Prirjet afatgjata të inflacionit dhe prirjet afatshkurtra 52
Grafik 40. Kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor. TPHI-ja dhe kontributet e përbërësve të tij 53
Grafik 41. Ecuria e ndryshimeve vjetore të NEER 54
Grafik 42. Ndikimi i drejtpërdrejtë i mbiçmimit të kursit të këmbimit për periudhën janar 2016 – qershor 2017, sipas muajve 55
Grafik 43. Dekompozimi i hendekut të inflacionit bazë sipas: hendekut të NEER; hendekut të prodhimit 55
Grafik 44. Pritjet inflacioniste të bizneseve dhe të konsumatorëve dhe të agjentëve financiarë, ndryshime vjetore në përqindje 57

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nxitja e investimeve afatgjata, ruajtja e fuqisë blerëse të parasë, rritja e eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetja e stabilitetit financiar, janë disa nga përfitimet e një mjedisi ekonomik të karakterizuar nga stabiliteti i çmimeve. Ky stabilitet është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në përputhje me strategjinë e miratuar në Dokumentin e Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0% në një periudhë afatmesme. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut.

Në përmbushje të këtij qëllimi dhe për të forcuar transparencën e saj, Banka e Shqipërisë përgatit dhe publikon çdo tre muaj Raportin e Politikës Monetare. Ky Raport është instrumenti kryesor i komunikimit të politikës monetare me publikun. Ai paraqet një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Raporti i referohet deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.37, datë 02.08.2017. Analiza ekonomike, financiare dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat më të fundit në dispozicion, deri më 21 korrik 2017.

1. FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare ka shënuar rritje në gjashtëmujorin e parë. Sipas të dhënave të INSTAT-it, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 3.9% në tremujorin e parë, duke pasqyruar kontributin pozitiv të pothuajse të gjithë sektorëve dhe degëve përbërëse të tij. Të dhënat e tërthorta të disponuara sugjerojnë një rritje pozitive, ndonëse në moderim të lehtë, edhe në tremujorin e dytë të vitit.

Në këndvështrimin e kërkesës agregate, zgjerimi i aktivitetit ekonomik ka reflektuar si rritjen e kërkesës së brendshme, ashtu dhe përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve me jashtë. Më në detaje:

- Konsumi dhe investimet private kanë vijuar të rriten në gjysmën e parë të vitit, si rrjedhojë e kushteve të favorshme të financimit, e përmirësimit të besimit në ekonomi, e rritjes së punësimit, si dhe e vijimit të flukseve të larta të investimeve të huaja direkte.
- Po ashtu, politika fiskale ka prodhuar një stimul pozitiv. Ndonëse kjo politikë ka ruajtur kahun e saj konsolidues edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit, çka është reflektuar në vlera pozitive të balancës buxhetore, intensiteti i konsolidimit fiskal shfaqet më i ulët krahasuar me një vit më parë.
- Nga ana tjetër, përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve tregtare ka reflektuar koniunkturën e favorshme ndërkombëtare, rritjen e vëmendjes ndaj Shqipërisë si destinacion turizmi, si dhe përmirësime strukturore në zinxhirin e nxjerrjes, të përpunimit dhe të tregtimit të naftës në vend.

Në tërësi, ecuria e aktivitetit ekonomik ka qenë në kahun e pritur, por norma e rritjes ishte më e lartë se projeksionet tona. Analizat tona tregojnë se ritmi i përmirësimit të bilancit të shkëmbimeve tregtare gjatë gjashtëmujorit të parë, si dhe madhësia e kontributit të tij pozitiv në PBB, janë diktuar nga faktorë që nuk janë përfaqësues të trendeve afatmesme. Për rrjedhojë, projeksionet tona për rritjen ekonomike të vitit 2017 kanë pësuar vetëm një rishikim të lehtë për lart.

Inflacioni i tremujorit të dytë shënoi një vlerë mesatare prej 2.0%, duke ardhur në rënie kundrejt vlerës mesatare prej 2.4% të tremujorit paraardhës. Rënia e inflacionit në këtë tremujor është ndikuar, pjesërisht, nga vlerat e larta të inflacionit të shënuara në tremujorin e parë si pasojë e goditjeve të ofertës dhe, pjesërisht, nga efekti rënës i ardhur nga mbiçmimi i kursit të këmbimit. Efekti i kursit të këmbimit ishte më i pranishëm në rënien e inflacionit të artikujve të importit, dhe – veçanërisht – të atyre ushqimorë. Nisur nga ecuria e tremujorit të

dytë, projeksioni ynë për inflacionin mesatar të vitit 2017 ka pësuar një rishikim të lehtë për poshtë, nga niveli 2.3% në nivelin 2.2%.

Nga ana tjetër, faktorët makroekonomikë me ndikim afatmesëm dhe afatgjatë në inflacion, janë në linjë me rritjen e mëtejshme dhe kthimin e tij në objektiv në afatin e mesëm. Kështu:

- Ekonomia shqiptare duket se po i afrohet gradualisht nivelit të potencialit, e reflektuar kjo si në rënien e normës së papunësisë ashtu edhe në trendin afatmesëm të rritjes së normës së shfrytëzimit të kapaciteteve. Ky përmirësim ciklik do të mundësojë një rritje graduale të pagave dhe një konvergjencë të marzheve të fitimit të biznesit drejt mesatareve historike.
- Paralelisht me të, efekti negativ i kursit të këmbimit pritet të shuhet gradualisht. Banka e Shqipërisë vlerëson se intensiteti aktual i mbiçmimit të kursit të këmbimit – i derivuar në masën më të madhe nga përmirësimi i shpejtë i bilancit të shkëmbimeve tregtare e të shërbimeve dhe nga flukset e larta të investimeve të huaja direkte – do të vijë drejt zbehjes. Në këto rrethana, efekti frenues që ky mbiçmim përcjell në inflacion pritet të vijë progresivisht drejt reduktimit në horizontin afatmesëm.

Tabloja e zhvillimeve aktuale dhe të pritura të PBB-së dhe të inflacionit është konsistente me ecurinë e tregjeve financiare dhe qëndrimin e politikës sonë monetare.

Politika monetare akomoduese që kemi ndjekur – nëpërmjet nivelit të ulët të normës bazë të interesit, nëpërmjet injektimit të vazhduar të likuiditetit, si dhe nëpërmjet informimit të tregut mbi kahun e ardhshëm të politikës monetare – është përcjellë plotësisht në tregjet financiare. Kjo politikë i ka sjellë normat e interesit në nivelet më të ulëta historike, ka ndihmuar në reduktimin progresiv të primeve të rrezikut dhe ka mundësuar rritjen vjetore me 9.3% të portofolit të kredisë në lekë.

Megjithatë, të dhënat e tremujorit të dytë të vitit sugjerojnë se ecuria e kredisë mbetet ende e moderuar. E pastruar nga efekti i çregjistrimit të kredive nga bilanci, kredia për sektorin privat shënoi një rritje mesatare prej 2% gjatë tremujorit të dytë, e ndikuar nga rënia vjetore prej 3.2% e portofolit të kredisë në valutë. Në terma sektorialë, aktiviteti kreditues shfaq një rritje më të shpejtë dhe më të qëndrueshme në segmentin e kredisë për individë, sidomos në drejtim të kredisë konsumatore, ndërkohë që rritja e kredisë për biznese shfaqet më e ngadaltë.

Ritmi ende i moderuar i rritjes së kredisë pasqyron si kërkesën e dobët për kredi, ashtu edhe politikat e kujdesshme të bankave në kredidhënie. Cikli rritës i investimeve është financuar, deri tani dhe në masën më të madhe, nga përdorimi i fondeve të veta të biznesit. Megjithatë, duke parë nga e ardhmja, nevoja në rritje për financim e bizneseve pritet të shoqërohet me rritje të kërkesës për kredi. Po kështu, përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit, reduktimi i rrezikut

të kreditit dhe përmirësimi i mëtejshëm i bilanceve të sistemit bankar, pritet të lehtësojnë ofertën e kredisë. Në këtë drejtim, reduktimi i mëtejshëm i raportit të kredive me probleme në muajin qershor e zbriti këtë tregues në nivelin 15.6%, duke ilustruar suksesin e masave tona por edhe duke dhënë sinjale inkurajuese për përmirësimin e ardhshëm të aktivitetit kreditues.

* * *

Duke gjykuar mbi trendet aktuale të ecurisë së ekonomisë, si dhe mbi faktorët përcaktues në ambientin e brendshëm e të jashtëm, Banka e Shqipërisë vlerëson se rritja ekonomike do të vazhdojë edhe në afatin e mesëm. Në skenarin tonë bazë, kjo rritje do të jetë e mjaftueshme për të vendosur ekonominë në ekuilibër dhe do të jetë faktori përcaktues për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2018.

Përmbushja e këtyre objektivave kërkon ndjekjen e një politike monetare akomoduese gjatë gjithë horizontit afatmesëm, për të kompensuar edhe efektin afatshkurtër frenues të kursit të këmbimit.

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë hartohet dhe zbatohet duke pasur si objektiv final arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Për t'iu përgjigjur presioneve të ulëta inflacioniste të shkaktuara nga rritja e ngadaltë e ekonomisë pas krizës financiare botërore, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese. Norma bazë e interesit është ulur gradualisht dhe qëndron në nivelin minimal historik prej 1.25%. Gjithashtu, komunikimi i politikës monetare ka synuar të sigurojë agjentët e tregut se normat e ulëta të interesit do të ruhen deri në plotësimin e kushteve për përmbushjen e objektivit të inflacionit. Nëpërmjet këtyre instrumenteve, politika monetare stimuluese ka luajtur një rol parësor për nxitjen e kërkesës së brendshme private, për fuqizimin e rritjes ekonomike dhe për vendosjen e inflacionit në një trajektore konverguese drejt objektivit.

Ecuria e aktivitetit ekonomik të tremujorëve të fundit ka qenë pozitive dhe pritjet tona janë për vijimin e kësaj tendence në afatin e mesëm. Stimuli monetar vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur rritjen e ekonomisë drejt ekuilibrit dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2018. Megjithatë, balanca e rreziqeve për materializimin e këtyre pritjeve është e zhvendosur poshtë. Nisur nga këto konsiderata, politika monetare do të vazhdojë të mbetet stimuluese, ndërsa vetë intensiteti i stimulit monetar do të përshtatet me nevojat e ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë.

Zhvillimet ekonomike e financiare në vend janë pozitive dhe konfirmojnë trendin rritës të ekonomisë shqiptare. Aktiviteti ekonomik vlerësohet të jetë zgjeruar me norma të larta rritjeje gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2017, por inflacioni është shfaqur i luhatshëm. Pas rritjes së tij në nivelin 2.4% në tremujorin e parë, inflacioni mesatar vjetor u ngadalësua në 2.0% në tremujorin e dytë. Në këtë ngadalësim kontribuan rënia e inflacionit të çmimeve të ushqimeve e të naftës dhe rënia e çmimeve të mallrave të qëndrueshme. Çmimet në kategoritë e tjera të shportës së konsumit ishin të qëndrueshme, duke kontribuar pozitivisht në formimin e inflacionit. Përgjatë tremujorit të dytë, inflacioni vjetor u rrit nga 1.9% në muajin prill, në 2.0% në maj dhe 2.2% në muajin qershor.

Faktorët makroekonomikë të cilët mbështesin rritjen e inflacionit drejt objektivit janë zgjerimi i vazhduar i kërkesës agregate dhe ankorimi më i mirë i pritjeve inflacioniste afatmesme. Nga ana tjetër, inflacioni i importuar vijon të jetë një faktor me ndikim të paqëndrueshëm. Tendencat mbiçmuese të kursit të këmbimit vlerësohet të kenë prodhuar një ndikim rënës në inflacionin e vitit të fundit[1]. Veprimi i këtij faktori është përforcuar edhe në prani të rritjeve më të ngadalta të çmimeve të lëndëve bazë e atyre të konsumit në vendet partnere, sesa parashikimet në fillim të vitit. Në vlerësimin tonë, këto goditje do të kenë një ndikim kalimtar dhe, në masën më të madhe, pritet të shuhen brenda vitit

[1] *Vlerësimet tona për përcjelljen e mbiçmimit të kursit të këmbimit në inflacion janë përmbledhur në hapësirën informuese 3: "Ndikimi i mbiçmimit të kursit të këmbimit në inflacion" në këtë raport.*

2017. Shtimi i presioneve të brendshme inflacioniste pritet të materializohet në një trend rritës e të qëndrueshëm të inflacionit gjatë vitit 2018.

Statistikat e publikuara nga INSTAT-i tregojnë për një rritje të shpejtë të aktivitetit ekonomik, përtej pritjeve tona, në tremujorin e parë të vitit 2017. Prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 3.9% në nivel vjetor, i mbështetur nga rritja e prodhimit në të gjithë sektorët e ekonomisë. Kjo ecuri reflektoi si rritjen e kërkesës së brendshme ashtu dhe rritjen e kërkesës së huaj. Ndër komponentët e kërkesës, kontributin kryesor në rritje e kanë dhënë investimet dhe konsumi privat. Përmirësimi i burimeve të financimit – flukset e larta hyrëse të investimeve të huaja direkte, rritja e punësimit – dhe i besimit të agjentëve ekonomikë kanë mbështetur rritjen e kërkesës së sektorit privat. Gjallërimi i konsumit dhe i investimeve është ndihmuar edhe nga kushtet e favorshme të financimit dhe rritja e kredisë për sektorin privat. Gjithashtu, shpenzimet buxhetore kanë ndikuar pozitivisht rritjen ekonomike të tremujorit të parë dhe të dhënat për tremujorin e dytë tregojnë për kontribut të ngjashëm. Së fundi, zhvillimet ekonomike në ambientin e huaj kanë qenë pozitive, duke mbështetur rritjen e eksporteve dhe aktivitetin turistik. Të dhënat e disponuara tregojnë për vazhdimësinë e këtyre tendencave edhe në tremujorin e dytë të vitit 2017.

Politika monetare lehtësuese e ndjekur prej Bankës së Shqipërisë vijon të jetë thelbësore në përmirësimin e kushteve të financimit, të cilat kanë përkrahur rritjen e investimeve dhe të konsumit, duke krijuar kështu premisa për rritjen e inflacionit drejt objektivit.

Norma bazë e interesit qëndron në nivelin më të ulët prej 1.25%, e pandryshuar që prej muajit maj 2016. Komunikimi i kursit të ardhshëm të politikës monetare ka synuar orientimin e pritjeve të agjentëve financiarë dhe ekonomikë mbi ruajtjen e politikës monetare lehtësuese edhe në horizontin e ardhshëm. Banka e Shqipërisë ka vazhduar të furnizojë tregun bankar me likuiditetin e nevojshëm, duke ndihmuar aktivitetin ndërmjetësues dhe qëndrueshmërinë e normave të interesit në tregun e parasë.

Në vijim të kësaj politike, tregjet financiare karakterizohen nga luhatje të vogla dhe norma të ulëta të interesit. Këto kanë vijuar të shënojnë rënie, duke reflektuar si përcjelljen e politikës monetare, ashtu dhe përmirësimin e bilanceve të sistemit bankar. Interesi mesatar i kredisë së re në lekë është ulur në 6.8% në gjashtëmujorin e parë 2017, nga 7.3% një gjashtëmujor më parë. Gjithashtu, vrojtimi i aktivitetit kreditues sugjeron përmirësimin e kushteve të financimit edhe nëpërmjet elementeve të tjera "joçmim" të kreditimit. Mbështetje më të lartë për financim vijojnë të gjejnë individët, ndërsa kushtet e kreditimit për bizneset janë të pandryshuara. Përmirësimet në treguesit ekonomikë dhe monetarë reflektohen në rikuperimin e kreditimit të sektorit privat, ndonëse me ritme të ngadalta. Duke përjashtuar efekte të kursit të këmbimit dhe të fshirjes së kredive me probleme, rritja vjetore e kredisë për sektorin privat është 4.0% në tremujorin e dytë. Kreditimi është udhëhequr nga rritja e kredisë në monedhën vendase, e cila ruan norma të qëndrueshme rritjeje, rreth nivelit 9.3%. Rritja

e ndërmjetësimit në monedhën vendase zgjeron hapësirat për transmetimin e stimulit monetar në ekonomi, si dhe redukton rreziqet e euroizimit për stabilitetin financiar. Banka e Shqipërisë pret që zhvillimet në kreditim të reflektojnë dhe më tej ecurinë pozitive të ekonomisë, përmirësimin e ambientit të kreditimit dhe të bilanceve të sistemit bankar. Treguesit e përfitueshmërisë së këtij të fundit janë ndihmuar nga ulja e kredive me probleme. Ky tregues ra në 15.6% në muajin qershor nga 18.2% në dhjetor.

Grafik 1. Normat e interesit në monedhën vendase



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pritjet për një ecuri pozitive të ekonomisë janë forcuar. Rritja e investimeve publike e private, rritja e shpenzimeve konsumatore dhe zgjerimi i eksporteve, pritet të reflektohen në rritje më të lartë ekonomike në vitin 2017. Në mungesë të goditjeve, ritmet pozitive të ekonomisë pritet të vijojnë në horizontin afatmesëm të veprimit të politikës monetare. Shfrytëzimi më i lartë i kapaciteteve prodhuese pritet të reflektohet në forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste, megjithëse ngadalësimi i inflacionit në tremujorin e dytë ka ulur shpejtësinë e rritjes së tij në afat të shkurtër. Norma e inflacionit total parashikohet të shënojë vlerën mesatare 2.2% në vitin 2017, kundrejt vlerës 1.3% vitin e kaluar. Përmirësimi i ekonomisë dhe mbyllja graduale e hendekut negativ të prodhimit pritet të sjellin rritje graduale të inflacionit drejt objektivit brenda vitit 2018.

Pritjet për ecurinë e inflacionit në afatin e mesëm janë të kushtëzuara nga ruajtja e kahut lehtësues të politikës monetare gjatë horizontit afatmesëm. Prania e kushteve monetare lehtësuese është e domosdoshme për rritjen graduale të inflacionit dhe kthimin e tij pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Kjo nënkupton që ekonomia do të vazhdojë të mbështetet nga norma të interesit poshtë atyre ekuilibër në horizontin afatmesëm. Megjithatë, përditësimi i analizës dhe parashikimeve në këtë raport sugjeron se rreziqet e kahut të poshtëm janë shtuar, në kushtet e pasigurive për ecurinë e ardhme të çmimeve në mjedisin e huaj dhe forcimit të kursit të këmbimit. Në këto rrethana, politika monetare duhet të ketë një natyrë më stimuluese në afatin e mesëm, krahasuar me vlerësimet tona paraardhëse.

3. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË

Ambienti ekonomik botëror ka shfaqur përmirësim në vitin 2017. Aktiviteti ekonomik është përmirësuar, ndonëse në mënyrë të pabarabartë midis ekonomive të ndryshme. Rritja ekonomike pritet të vijojë përgjatë gjithë vitit në vazhdim. Rreziqet ndaj këtij parashikimi janë të pranishme kryesisht në anën e poshtme, por në zbehje. Normat në rritje të inflacionit në tremujorin e parë u vërtetuan si të ndikuara nga faktorë kalimtarë, dhe shënuan rënie në tremujorin e dytë të vitit. Tregjet financiare kanë dëshmuar luhatshmëri të ulët, nën efektin e përmirësimit të aktivitetit ekonomik ndërkombëtar.

3.1. EKONOMIA BOTËRORE

Treguesit ekonomikë botërorë të muajve të fundit sugjerojnë vijim të rritjes ekonomike në ambientin e jashtëm. Treguesi i përbërë botëror i prodhimit dhe i ekonomisë[2], si dhe treguesi paraprijës i PBB-së regjistruan rritje në muajt prill, maj dhe qershor, duke konfirmuar ecurinë pozitive të aktivitetit ekonomik. Në tremujorin e parë, PBB-ja e disa shteteve kryesore të zhvilluara e ka zbutur ritmin e rritjes, por gjithsesi, ky ngadalësim nuk ka sjellë ngadalësimin e aktivitetit ekonomik botëror. Dinamika e tregtisë botërore është përmirësuar, e nxitur kryesisht nga rritja e ekonomive në zhvillim. Tregjet financiare karakterizohen nga një luhatshmëri e ulët. Megjithatë, pasiguritë mbi politikat ekonomike të shteteve të mëdha mund të krijojnë tensione në këto tregje, duke ndikuar

Grafik 2. Treguesi i përbërë paraprijës i PBB-së (CLI) dhe Prodhimi Industrial i vendeve kryesore* (majtas) dhe inflacioni (djathtas)



Burimi: OBZHE.

Prodhimi industrial është ndryshim mujor, ndërkohë që trendi afatgjatë i CLI-së është 100. Vendet kryesore janë ato të OBZHE-së (OECD) dhe Brazil, Kinë, Rusi, Indi dhe Afrikë e Jugut.

[2] *The global composite output PMI dhe Global manufacturing PMI, Markit, prill, maj dhe qershor 2017.*

negativisht vlerësimet e investitorëve. Inflacioni ka ruajtur norma të qëndrueshme në tremujorin e dytë, duke reflektuar zbutjen e efekteve të rritjes së mëparshme të çmimeve të mallrave. Rënia e çmimeve të naftës në javët e fundit, pritet të frenojë inflacionin global në afat të shkurtër.

EKONOMIA E SHBA-SË

Ekonomia e ShBA-së është rritur në tremujorin e parë të vitit. Shifrat paraprake treguan një ngadalësim, por përditësimi i të dhënave tregon se tendenca e rritjes ekonomike të tremujorëve të mëparshëm ka vazhduar edhe në vitin 2017. Mbështetësit kryesorë të ekonomisë kanë qenë rritja e investimeve (rezidenciale dhe jorezidenciale) dhe zgjerimi i eksporteve. Shpenzimet konsumatore, ndonëse me një normë rritjeje më të ulët, kanë kontribuar gjithashtu pozitivisht në kërkesën agregate. Mungesa e materializimit të stimulit të pritshëm fiskal është treguar në kontributin negativ të shpenzimeve të qeverisë qendrore dhe lokale. Efekti i këtyre të fundit, bashkë me rritjen e importeve, ka tërhequr poshtë rritjen ekonomike në tremujorin e parë. Tregu i punës vijon të shfaqë ecuri pozitive, ku norma e papunësisë po ndjek një trajektore rënëse prej disa tremujorësh. Treguesit paraprakë me frekuencë më të lartë dëshmojnë për vijimin e përmirësimit të aktivitetit ekonomik në periudhën në vazhdim. Treguesit e shitjeve me pakicë, prodhimi industrial dhe indeksi i besimit të konsumatorëve, kanë qenë në rritje.

Pas vlerave mbi 2% të shënuara në tremujorin e parë, inflacioni ka ndjekur një tendencë rënëse në tremujorin e dytë të vitit, duke iu larguar shënjestrës së Rezervës Federale. Norma e inflacionit bazë ka shënuar rënie gjithashtu, duke ulur mundësinë për një shtrëngim tjetër monetar në tremujorin në vazhdim.

Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së T1-2017		Norma e papunësisë*	Norma vjetore e inflacionit	
	Tremujor	Vjetor	T2-20017	T1/2017	T2/2017
ShBA	0.3	2.1	4.4	2.5	1.9
Eurozonë	0.6	1.9	9.3	1.8	1.3
Gjermani	0.6	1.7	4.5	1.9	1.7
Francë	0.4	1.0	9.6	1.1	0.9
Mbretëri e Bashkuar	0.2	2.0	4.6	2.1	2.7

Burimi: Eurostat dhe institutet statistikore përkatëse.
**Të dhënat e punësimit në Eurozonë dhe Mbretërinë e Bashkuar janë deri në maj 2017.*

EKONOMIA E EUROZONËS

Ekonomia e Eurozonës ka shënuar një rritje prej 0.6% në tremujorin e parë të vitit. Kjo shifër ka qenë më e lartë se tremujorët e mëparshëm, si edhe i ka kaluar vlerësimet dhe pritjet paraprake të agjentëve financiarë. Faktorët që kanë kontribuar pozitivisht kanë qenë shpenzimet konsumatore dhe investimet. Kërkesa e huaj, ndërkohë, ka qenë me ndikim neutral këtë tremujor. Treguesit

e tërthortë dhe ata paraprakë mbi dinamikën e prodhimit në tremujorin e dytë sugjerojnë për vijimin e rritjes ekonomike në Eurozonë, me të njëjtat ritme si ato të tremujorit të parë. Lehtësimi i vazhdueshëm i politikës monetare dhe kushtet më të favorshme të financimit në tregjet financiare janë reflektuar tek rritja e kredisë ndaj bizneseve dhe individëve gjatë kësaj periudhe. Rreziqet ndaj rritjes shfaqen të balancuara, ku zhvillimet politike botërore qëndrojnë në anën e poshtme. Inflacioni ka shfaqur ngadalësim në tremujorin e dytë, pas rritjes afër nivelit të shënjestruar nga BQE-ja në tremujorin e parë. Për më tepër, inflacioni bazë vijon të jetë i ulët. Projeksionet e fundit e shikojnë atë në rritje graduale në terma afatmesëm.

Ekonomitë e vendeve kryesore partnere tregtare të Shqipërisë, Italia dhe Greqia, kanë treguar përmirësim të aktivitetit ekonomik në tremujorin e parë të vitit. Ekonomia e Italisë ka përfituar nga rritja e shpenzimeve konsumatore dhe e investimeve. Në të kundërt, rritja e eksporteve është kompensuar nga rritja e fortë e importeve, duke tërhequr poshtë rritjen e kërkesës agregate. Të dhënat paraprake për periudhën në vazhdim tregojnë për një përmirësim të konsumit dhe të prodhimit industrial, ndërsa papunësia ka shënuar një rritje të lehtë. Ekonomia e Greqisë është rikthyer me rritje pozitive në tremujorin e parë të vitit, falë rritjes së fortë të investimeve dhe përmirësimit të shpenzimeve konsumatore. Rritja e ndjeshme e importeve ka ndikuar negativisht në rritjen ekonomike agregate. Treguesit paraprakë sugjerojnë një rritje të konsumit në periudhën në vazhdim, por situata është e veshur me pasiguri në lidhje me rifinancimin e borxhit publik. Inflacioni në të dy vendet ka ndjekur një prirje lehtësisht rënëse, duke qëndruar nën nivelin e shënjestruar nga BQE-ja.

Grafik 3. Indeksi i përbërë i prodhimit (PMI), PBB-ja tremujore dhe treguesi i ndjesisë ekonomike (majtas) dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin dhe konsumatorët (djathtas)



Burimi: Markit, Eurostat, Komisioni Evropian.

EKONOMITË E RAJONIT[3]

Ecuria e ekonomive të rajonit ka dëshmuar rritje ekonomike pozitive në tremujorin e parë të vitit, e ushqyer nga shpenzimet konsumatore, të cilat kanë shënuar zgjerim në të gjitha vendet e rajonit, dhe nga eksportet neto. Përjashtim nga kjo ecuri bën Maqedonia, ku turbullirat politike kanë ndalur rritjen ekonomike. Të dhënat paraprake tregojnë se rritja ekonomike në rajon do të vazhdojë, e mbështetur nga kërkesa e brendshme dhe ajo e huaj, e cila pritet të përfitojë nga mjedisi më i mirë ekonomik i partnerëve tregtarë evropianë. Normat e inflacionit në vendet e rajonit kanë tendencë të afrohen drejt normave të shënjestruara nga bankat qendrore, me zbehjen e efektit bazë të çmimeve të ushqimeve dhe energjisë në vitin e kaluar.

Ritmi i aktivitetit ekonomik ka qenë i pabarabartë ndërmjet vendeve. Ekonomia e Turqisë e ka përshpejtuar atë në tremujorin e parë të vitit, e ndihmuar nga shpenzimet e larta qeveritare dhe nga rritja e eksporteve neto. Edhe shpenzimet konsumatore janë rritur, ndonëse në terma të ngadaltë. Kjo tendencë pritet të vazhdojë edhe në tremujorët e ardhshëm, me investimet publike në rritje dhe shpenzimet konsumatore të zbehta. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në Serbi është frenuar në tremujorin e parë. Ngadalësimi ka ardhur nga faktorë të përkohshëm klimatikë, që kanë ndikuar në sektorin e energjisë dhe në ecurinë e investimeve. Shpenzimet konsumatore dhe eksportet neto kanë kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike. Ekonomia e Maqedonisë përjetoi stanjacion në tremujorin e parë. Situata e trazuar politike ka ndikuar në nivelin e investimeve dhe pasiguria ka frenuar prodhimin vendas, duke sjellë frenimin e eksporteve. Shpenzimet konsumatore kanë shënuar rritje. Me qartësimin e situatës politike, pritet që ekonomia të përmirësohet në periudhën në vazhdim. Ekonomia e Kosovës ka përshpejtuar ritmin e rritjes në tremujorin e parë të vitit. Ky përmirësim është nxitur nga ecuria e mirë e shpenzimeve konsumatore, e investimeve dhe e eksporteve neto. Shpenzimet qeveritare kanë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike.

Normat e inflacionit kanë shfaqur përmirësim në vendet e rajonit. Në Turqi inflacioni vijon të mbetet i lartë, mbi intervalin e sipërm të normës së shënjestruar nga banka qendrore e Turqisë. Në muajin qershor, ai shënoi një zvogëlim, nën ndikimin e çmimit të ushqimeve dhe energjisë. Në Maqedoni dhe Kosovë, norma e inflacionit është rritur, duke iu larguar normave të ulëta të tremujorit të kaluar. Kjo ecuri është ndikuar nga rritja e çmimeve në partnerët e tyre tregtarë. Inflacioni në Serbi ka shënuar një zvogëlim, duke mbetur mbi normën e shënjestruar nga banka qendrore, por brenda intervalit të saj të tolerancës.

[3] *Vendet kryesore partnere tregtare në Ballkan, joanëtare të BE-së.*

Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet fqinje

Vendet	Ndryshimi vjetor i PBB-së		Inflacioni vjetor	Norma e papunësisë
	T4-2016	T1-2017	Qershor-2017	T1 - 2017
Itali	1.1	1.2	1.2	11.3†
Greqi	-1.0	0.4	1.0	21.7*
Maqedoni	2.4	0.0	1.5	22.9
Serbi	2.5	1.2	3.6	14.6
Turqi	3.5	5.0	10.9	10.5*
Kosovë	3.0	3.8	1.9	30.5
Shqipëri	4.1	3.9	2.2	14.2

Burimi: Institutet statistikore përkatëse.
*Shënim: *Vlera për muajin prill 2017; †Vlera për muajin maj 2017.*

3.2. ECURIA E ÇMIMEVE TË MALLRAVE KRYESORE NË TREGJET BOTËRORE

Çmimet e mallrave bazë kanë vijuar tendencën ngadalësuese të rritjes së tyre në tremujorin e dytë të vitit, me disa indekse kryesore që kanë kaluar në tkurrje vjetore në muajin qershor. Kjo tendencë e nisur që në fillimin e vitit, është ndikuar nga efekti bazë i çmimeve të energjisë e të ushqimeve në fillimin e vitit 2016. Rritja e indeksit të mallrave ka vijuar tendencën ngadalësuese, duke arritur në territor negativ në muajin qershor. Indeksi i naftës ka treguar një sjellje të ngjashme, duke kaluar nga rritje të larta dyshifrore në tremujorin e parë, në rritje të lehtë negative në muajin qershor. Indeksi i çmimeve të ushqimeve vijon të rritet me ritme në ngadalësim, duke shënuar rritje vjetore negative në muajin e fundit. Inflacioni i ulët i këtyre çmimeve vjen nga oferta më e lartë në disa vende të mëdha prodhuese të drithërave. Indeksi i çmimit të metaleve vijon të shënojë një rritje pozitive, duke pasqyruar kërkesën e lartë të vendeve të zhvilluara, në të cilat investimet janë në përmirësim.

Çmimi i Naftës Brent shënoi një zvogëlim të mëtejshëm, duke arritur në rreth 46.4 USD/fuçi në muajin qershor. Ndonëse vendet e OPEC-ut reduktuan

Grafik 4. Ndryshimet vjetore të çmimeve të mallrave bazë



Burimi: EIA, FMN, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

prodhimin e tyre, oferta është shtuar nga vendet jashtë OPEC-ut, të cilat kanë vendosur të mbulojnë një pjesë më të madhe të tregut.

Çmimet e produkteve të naftës, të ushqimeve dhe të metaleve pritet të mbeten në nivelet aktuale deri në fund të vitit 2017, me një tendencë lehtësisht rritëse më tej, si pasojë e pritjeve për aktivitet ekonomik të përmirësuar në botë.

Grafik 5. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore



Burimi: Bankat qendrore (BQE, Fed, BJ dhe BA).

3.3. TREGJET FINANCIARE

Komiteti Federal i Tregut të Hapur (FOMC) i FED-it rriti normën bazë me 0.25 pikë përqindje në 1.25% në mbledhjen e muajit qershor. Bankat e tjera qendrore kryesore i lanë të pandryshuara normat e tyre bazë të interesit, respektivisht BQE-ja në 0.0%, Banka e Anglisë në 0.25% dhe Banka e Japonisë në -0.1%.

Interesat e instrumenteve në tregun e parasë në Eurozonë nuk kanë ndryshuar në tremujorin e dytë, duke mbetur në nivele të ulëta. *Yield*-et e titujve qeveritarë dhe të bizneseve kanë treguar një ecuri të lehtë rënëse. Prej fillimit të tremujorit të dytë, qetësia nga rezultatet e zgjedhjeve në Francë, si dhe publikimi i shumë treguesve makroekonomikë pozitivë mbi pritjet e agjentëve financiarë, kanë përcaktuar një rënie të përgjithshme të primeve sovrane tek shumë shtete në Eurozonë. Përmirësimi i klimës së përgjithshme të biznesit ka qenë një tjetër faktor që ka ndikuar në uljen e primeve në tregjet financiare të Evropës. Diferencat e titujve të shteteve me detyra konsolidimi fiskal ndaj obligacioneve të Gjermanisë janë zvogëluar këta tre muaj.

Grafik 6. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Bloomberg, Reuters dhe Eurostat.

Gjatë tremujorit të dytë, euro është mbiçmuar ndaj dollarit amerikan. Euro ka përfituar nga ecuria dhe perspektiva pozitive e ecurisë ekonomike në vend. Në terma mesatarë, krahasuar me tremujorin e parë, ajo u mbiçmua me 3.5% ndaj dollarit amerikanë. Mesatarisht, në muajin qershor, një euro u këmbye me 1.123 dollarë amerikan, duke qenë 5.5% mbi nivelin e fillimit të muajit prill.

4. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE

Kushtet monetare në ekonomi vijuan të jenë lehtësuese edhe gjatë tremujorit të dytë. Nivelet e kënaqshme të likuiditetit, primet e ulëta të rrezikut dhe përmirësimi i bilanceve bankare, kanë ndihmuar në përcjelljen e plotë të sinjaleve të politikës monetare në ekonomi. Kështu, norma mesatare e interesit të kredisë në lekë është ulur dhe së bashku me lehtësimin e standardeve të tjera të kreditimit ka mbështetur rritjen e kredisë. Kushtet stimuluese kanë ndikuar në rritjen e kreditimit për individë, ndërsa kredia për biznese shfaqet e ngadalësuar, duke përcaktuar ritme më të ulëta të rritjes së kredisë për sektorin privat. Nga ana tjetër, portofoli i kredisë në bilancet e bankave është ndikuar edhe nga shlyerjet e kredive me probleme dhe nga mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhave të huaja. Përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë ka përkrahur forcimin e lekut në këtë periudhë. Ritmet e moderuara të ekspansionit monetar sjellin presione të ulëta inflacioniste mbi çmimet e konsumit në vend.

4.1. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

TREGU NDËRBANKAR

Tregu ndërbankar është karakterizuar nga norma të ulëta interesi gjatë tremujorit të dytë. Interesat e aplikuara nga bankat në këtë segment janë luhatur kryesisht poshtë normës bazë. Ato kanë ruajtur diferenca minimale kundrejt saj, në linjë me objektivin operacional të politikës monetare. Treguesit e luhatshmërisë[4] paraqiten pranë niveleve të ulëta të tremujorit të kaluar. Vëllimi i shkëmbyer ka

Grafik 7. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së (majtas) dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[4] *Devijimi standard i normave ditore të interesit në tregun ndërbankar në tremujorin e dytë ishte 0.075 nga 0.054 një tremujor më parë.*

qenë i ngjashëm me atë të tremujorit të parë të vitit. Maturitetet kryesore mbeten ato ditore dhe javore, por krahas tyre janë shtuar edhe transaksionet 2- dhe 3-ditore. Tregu ndërbankar është karakterizuar nga një situatë e qetë likuiditeti, e cila ka mbështetur luhatjet e pakta të normave të interesit. Banka e Shqipërisë ka vijuar të ofrojë likuiditet me anë të instrumentit të saj kryesor, repos 7-ditore, si dhe nëpërmjet marrëveshjeve repo me maturitet 3-mujor. Shuma mesatare e injektuar ka qenë lehtësisht më e madhe se tremujorin e kaluar, ndërkohë që normat e interesit kanë rezultuar shumë pranë normës bazë.

TREGU I BRENDSHËM VALUTOR

Leku ka vijuar të forcohet gjatë tremujorit të dytë të vitit, madje me ritëm më të përshpejtuar në muajt maj dhe qershor. Në terma nominalë efektivë[5], mbiçmimi vjetor i lekut shënoi vlerën 4.6% në këtë tremujor, duke u thelluar nga vlerat 3.5% dhe 3.2%, që shënonte përkatësisht në tremujorin e parë të vitit dhe në vitin 2016. Kjo ecuri ka reflektuar mbiçmimin më të fortë të lekut kundrejt euros gjatë kësaj periudhe, në një kohë që ai ka vijuar të forcohet me ritme të njëjta kundrejt monedhave të tjera të shportës. Në terma realë vjetorë, leku është mbiçmuar me mesatarisht 4.4% në këtë tremujor, nga 4.0% një tremujor më parë. Mbiçmimi më i vogël real kundrejt atij nominal në këtë tremujor ka reflektuar diferencën negative të inflacionit në vend me atë mesatar të vendeve partnere[6] .

Grafik 8. Ecuria e kursit efektiv të këmbimit dhe e monedhave individuale të shportës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[5] *Kursi nominal efektiv i këmbimit (KNEK/NEER) llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë (Italì, Greqi, Gjermani, Turqi dhe Kinë), duke përdorur peshat përkatëse në tregti. Me qëllim përllogaritjen e kursit lira/lek dhe renminbi/lek, kursi zyrtar referues mbetet ai i lirës turke dhe renminbit kinez ndaj dollarit amerikan. Kursi real efektiv i këmbimit (KREK/REER) llogaritet në mënyrë të ngjashme si ai nominal, por merr parasysh edhe inflacionin në vend dhe në partnerët tregtarë.*

[6] *Norma e inflacionit në vend ka qenë më e ulët se inflacioni mesatar në vendet partnere në këtë tremujor.*

Forcimi i monedhës vendase ka pasqyruar së fundi përmirësimin e pozicionit të jashtëm të ekonomisë – ngushtimin e deficitit të llogarisë korrente (si rrjedhojë e ngushtimit të deficitit tregtar të mallrave dhe rritjes së suficitit të shërbimeve), dhe bashkë me të edhe rritjen e flukseve hyrëse neto të llogarisë kapitale e financiare. Kjo e fundit është ndikuar nga vazhdimi i hyrjeve të larta të investimeve të huaja direkte, të cilat kanë qenë më shumë se të mjaftueshme për të mbuluar deficitin e llogarisë korrente[7]. Për rrjedhojë, hyrjet e valutës në ekonomi kanë qenë ndjeshëm më të larta se daljet, dhe një pjesë e tyre është përkthyer si tepricë oferte valutore në treg.

Forcimi i lekut kundrejt monedhës evropiane ka qenë më i pranishëm në muajt maj dhe qershor. Kursi i këmbimit u shfaq i qëndrueshëm në periudhën shkurt-prill, rreth vlerës 135.5 lekë/euro, por ra në 134.6 lekë/euro në muajin maj dhe, më tej, në 133.2 lekë/euro në muajin qershor. Në terma vjetorë, forcimi i lekut në këta dy muaj ishte përkatësisht 2.7% dhe 3.4%, nga mesatarisht 2.1% që ishte në katër muajt e parë të vitit.

Mbiçmimi i monedhës vendase kundrejt euros nuk është fenomen vetëm në Shqipëri. Gjatë vitit 2017, të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që zbatojnë regjim të lirë të kursit të këmbimit, me përjashtim të Rumanisë, po shohin mbiçmim të monedhave të tyre. Ndër faktorët që kanë përcaktuar forcimin e monedhave të këtyre vendeve janë reduktimi i kundërshtisë ndaj rrezikut të investitorëve të huaj dhe vlerësimi në rënie i primit të rrezikut të lidhur me investimet në vendet e rajonit, të cilat po përjetojnë përmirësim të situatës makroekonomike. Ky fenomen është përforcuar edhe më shumë nga politika monetare tejet akomoduese e ndjekur nga BQE-ja, e cila ka kontribuar në rritjen e likuiditetit (afatshkurtër) në euro.

Grafik 9. Ecuria e kursit efektiv të këmbimit dhe e monedhave individuale të shportës



*Rajoni përfshin Serbinë, Rumaninë, Poloninë, Hungarinë dhe Çekinë.
Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat qendrore të vendeve të tjera.

[7] *Për periudhën 2016T4-2017T1, shkalla e mbulimit, ka qenë mesatarisht në nivelin 107%. Më shumë detaje mbi ecurinë e bilancit tregtar dhe atij të pagesave mund të gjeni në Hapësirën Informuese 2: "Zhvillimet në Bilancin e Pagesave në tremujorin e parë të vitit 2017" në këtë raport.*

Ecuria e kursit usd/lek ka qenë në linjë me zhvillimet në tregun ndërkombëtar valutor, duke reflektuar edhe forcimin e lekut kundrejt euros. Vlera e dollarit amerikan ka rënë ndjeshëm në tremujorin e dytë të vitit, duke zbritur nga 126.7 lekë/usd në muajin mars, në 118.6 lekë/usd në muajin qershor, duke shënuar një nënçmim mesatarisht me 2.2% në muaj gjatë tremujorit të dytë (1.6% kundrejt euros në tregun ndërkombëtar). Kundrejt një viti më parë, kursi usd/lek ka kthyer tendencën mbiçmuese të dollarit dhe në muajin maj dhe në qershor rezulton 3.4% më i ulët në terma vjetorë.

Zhvillimet e vërejtura në gjysmën e parë të muajit korrik tregojnë për qëndrueshmëri të kursit euro/lek pranë niveleve të vërejtura në fund të muajit qershor. Dollari amerikan ka vijuar të nënçmohet në tregun vendas, në linjë me nënçmimin e tij kundrejt euros në tregun ndërkombëtar.

TREGU PRIMAR

Yield-et e **bonove dhe të obligacioneve** të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë kanë shfaqur ecuri rritëse në periudhën maj-korrik. Pasi e filluan tremujorin e dytë me të njëjtën prirje rënëse që karakterizoi fundin e tremujorit të parë, *yield*-et e letrave me vlerë iu rikthyen kahut rritës në muajin maj. Rritja e *yield*-eve ka qenë e pranishme tek të gjitha maturitetet e tregtuara[8], por më e përmbajtur se ajo e vërejtur në fund të 2016-ës. Ankandet e tremujorit të dytë janë karakterizuar nga një raport i mbulimit të kërkesës për fonde të qeverisë mbi 1, por në nivele më të ulëta në krahasim me tremujorin e parë të vitit[9]. Kjo dinamikë e *yield*-eve është reflektuar në rritjen e nivelit të kurbës së *yield*-eve, ndërkohë që pjerrësia e saj ka mbetur thuajse e pandryshuar.

Grafik 10. *Yield*-et në tregun primar*



*Në grafik janë përfshirë ankandet e kryera deri në datë 20 korrik 2017.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[8] *Përveç bonos 3-mujore, e cila nuk ka pasur emetime gjatë kësaj periudhe.*

[9] *Treguesi bid/cover për ankandet e zhvilluara në tremujorin e dytë rezultoi 1.13 për bonon 12-mujore dhe 1.2 për obligacionet. Në tremujorin e parë të vitit, këta tregues ishin përkatësisht 1.5 dhe 1.6.*

Yield-i mesatar për bonot e thesarit 12-mujore u rrit në 2.05% në muajin qershor, nga 1.79% që shënonte në muajin prill. Edhe në ankandin e kryer në javën e parë të muajit korrik, *yield*-i i bonos 12-mujore ka regjistruar sërish rritje, në 2.10%. *Yield*-et e **obligacioneve** kanë ndjekur tendencën e *yield*-it të bonove të thesarit 12-mujore. *Yield*-i i obligacionit 2-vjeçar (i cili ka emetime të rregullta mujore) ka shënuar rritje të njëpasnjëshme, duke rezultuar 2.64% në ankandin e fundit në muajin korrik, nga 2.25% që ishte në muajin prill. *Yield*-i i obligacionit 7-vjeçar u rrit në 5.39%, nga 5.24% që shënonte në ankandin paraardhës (mars). Përjashtim nga kjo ecuri bën obligacioni 5-vjeçar, *yield*-i i të cilit ra në 4.95% në muajin maj, nga 5.15% që shënonte në muajin shkurt[10].

4.2. NORMAT E INTERESIT TË DEPOZITAVE DHE KREDIVE DHE KUSHTET E FINANCIMIT[11]

Normat e interesit për **depozitat e reja në lekë** janë shfaqur të qëndrueshme, pranë niveleve minimale të tyre. Norma mesatare e interesit rezultoi 0.89%, nga 0.91% që shënonte mesatarisht në tremujorin e parë. Politika monetare lehtësuese e Bankës së Shqipërisë është reflektuar në kosto të ulët të financimit të aktivitetit bankar, duke mundësuar norma më të ulëta interesi të kredive për sektorin privat. Norma mesatare e interesit për **depozitat e reja në euro** në këtë tremujor, prej 0.16%, ka rezultuar gjithashtu pranë nivelit mesatar të tremujorit të parë të vitit. Diferenca mes normave të interesit të depozitave në monedhën vendase dhe atyre në euro vijon të jetë minimale, rreth nivelit 0.7 pikë përqindje.

Grafik 11. Normat e interesit për depozitat e reja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[10] *Ankandi i këtij obligacioni u zhvillua në javën e parë të muajit maj 2017. Yield-i i bonove12-mujore të thesarit, i cili përdoret si referencë për obligacionet, në muajin maj ishte më i vogël se ai i muajit shkurt, kur u zhvillua ankandi i mëparshëm për obligacionin 5-vjeçar (përkatësisht 1.98% në muajin maj dhe 2.93% në muajin shkurt).*

[11] *Të dhënat më të fundit zyrtare për normat e interesit për kreditë dhe depozitat e reja i përkasin muajit qershor 2017.*

Interesat për **kredinë e re në lekë** kanë regjistruar ulje në tremujorin e dytë të vitit; norma mesatare e interesit rezultoi 6.42%[12], nga 7.23% që shënonte në tremujorin e parë. Ato vijojnë të kenë luhatshmëri të lartë ndër muaj[13] dhe të ndikohen nga kredi specifike, kryesisht në segmentin afatshkurtër, të dhëna nga banka të veçanta. Përtej kësaj luhatshmërie, ato karakterizohen nga një tendencë e lehtë rënëse, në reflektim të politikës monetare dhe të përcjelljes së saj në segmentet e tregut financiar. Ecuria e normave të interesit është diktuar kryesisht nga tendenca rënëse e normave të interesit për kreditë për bizneset private, si për financimin e nevojave për likuiditet, ashtu edhe për financimin e investimeve. Edhe individët kanë përfituar nga norma lehtësisht më të ulëta në tremujorin e dytë të vitit për financimin e konsumit dhe të blerjeve të pasurive të paluajtshme. Megjithatë, normat e interesit për kreditë hipotekare mbeten mbi nivelin më të ulët të tyre të shënuar në pjesën e dytë të vitit të kaluar.

Grafik 12. Normat e interesit për kredinë e re, mesatare rrëshqitëse 6-mujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesi mesatar për **kredinë e re në euro** rezultoi 4.69% në tremujorin e dytë të vitit, duke qëndruar pranë mesatares së tre tremujorëve paraardhës. Normat mesatare të interesit të kredisë për bizneset private janë ulur për kreditë për likuiditet dhe janë rritur për kreditë për investime. Interesat në segmentin e individëve janë shfaqur në rënie të lehtë për kreditë hipotekare dhe kanë mbetur thuajse të pandryshuara për kreditë konsumatore. Diferenca e normës mesatare të kredisë në lekë kundrejt asaj në euro ka ardhur në rënie në tremujorin e parë e të dytë të vitit krahasuar me gjysmën e dytë të vitit të kaluar. Ngushtimi i kësaj diference ka vazhduar të mbështesë zhvendosjen e strukturës së portofolit të kredisë, nga valuta drejt lekut.

[12] *Norma mesatare e kredisë së re në lekë për tremujorin e dytë të vitit, e pastruar nga efekti i dy kredive specifike të dhëna në muajin prill dhe në muajin qershor, rezulton 6.58%.*

[13] *Me norma veçanërisht të ulëta prej 5.25% në muajin prill ose veçanërisht të larta në muajin qershor prej 7.48%.*

Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e dytë të vitit 2017[14] tregojnë për standarde kreditimi kryesisht të pandryshuara për segmentin e bizneseve, pas katër tremujorësh shtrëngimi të njëpasnjëshëm. Ndërkohë që standardet e kredisë për likuiditet kanë shfaqur lehtësim, standardet e kredisë për investime janë shtrënguar. Ulja e komisioneve ka ndikuar pozitivisht në lehtësimin e standardeve, por kërkesat e rritura për kolateral kanë ndikuar në kahun e kundërt.

Grafik 13. Kushtet e kreditimit
(për biznese majtas, për individë djathtas - balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kreditues, Banka e Shqipërisë.

Standardet e kreditimit në segmentin e individëve kanë njohur lehtësim edhe në këtë tremujor. Lehtësimi është shprehur më tepër për kreditë konsumatore, ndërsa kushtet për financimin e kredive për shtëpi nuk kanë shfaqur ndryshim. Përqasja lehtësuese e bankave ndaj këtij segmenti është materializuar nëpërmjet përmirësimit të raportit të kështit ndaj të ardhurave, rritjes së madhësisë së kredisë, zvogëlimit të komisioneve, si edhe lehtësimit të kërkesave për kolateral.

4.3. KREDITIMI I SEKTORIT PRIVAT[15]

Kredia për sektorin privat ka vijuar të shfaqë rritje të moderuar edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit. Ky portofol u zgjerua mesatarisht me 2% në terma vjetorë, krahasuar me normën prej 3.1% në tremujorin paraardhës. Ngadalësimi i rritjes së kredisë për sektorin privat reflekton kryesisht tkurrjen e portofolit të kredisë në valutë (-3.2%), tkurrje e cila mbart efektin e mbiçmimit të monedhës vendase ndaj euros dhe dollarit amerikan, veçanërisht në muajt maj dhe qershor. Rregulluar për këtë efekt, portofoli i kredisë për sektorin privat shënon

[14] *Për më shumë detaje: https://www.bankofalbania.org/web/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues_5311_1.php*

[15] *Analiza e kredisë bazohet në të dhënat monetare të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci. Të dhënat e kredisë për muajin qershor janë paraprake.*

rritje vjetore mesatare rreth vlerës 4% në tremujorin e dytë. Kredia në lekë vijon të karakterizohet nga një ecuri e qëndrueshme, e mbështetur si nga oferta e favorshme për kredi edhe nga kërkesa në rritje për financim në monedhë vendase. Portofoli i kredisë në lekë u zgjerua mesatarisht me 9.3% në terma vjetorë në këtë tremujor.

Raporti i kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së vlerësohet në rreth 36.5% në fund të tremujorit të dytë të vitit. Zhvillimet në aktivitetin kreditues reflektojnë një përmirësim të ngadaltë të kërkesës për kredi dhe kushte të shtrënguara kreditimi për bizneset. Megjithatë, ecuria e mirë e kredive të reja të disbursuara gjatë pjesës së parë të vitit, si dhe rritja e vazhdueshme e portofolit të kredisë cilësore sugjerojnë përmirësime të vazhdueshme strukturore në tregun e kredive. Gjithashtu, portofoli i kredisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit është ndikuar ndjeshëm edhe nga shlyerjet e larta të kredive me probleme.

Grafik 14. Kredia për sektorin privat sipas monedhës dhe agjentëve ekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet sipas segmenteve konfirmojnë rritje të moderuar të **kredisë për biznese.** Ky portofol është ndikuar gjerësisht nga ecuria e kursit të këmbimit gjatë kësaj periudhe, si pasojë e strukturës valutore që e dominon atë. Norma vjetore e kredisë për biznese, e korrektuar për efektin e kursit të këmbimit, shënoi rritje mesatare rreth vlerës 2% në tremujorin e dytë. Në vitet e fundit, zhvillimet në kredinë për biznese reflektojnë një kërkesë të dobët për kredi dhe kushtet e shtrënguara të kreditimit, veçanërisht për biznesin e madh. Për më tepër, gjatë vitit 2017, ky portofol është ndikuar ndjeshëm nga shlyerjet e kredive me probleme[16], si dhe nga ecuria e kursit të këmbimit. Sipas qëllimit të përdorimit, kredia për likuiditet shfaqet me reduktim vjetor mesatarisht prej 0.4%. Kredia për investime është ngadalësuar në 3.9% mesatarisht, përkundrejt 4.8% të shënuar në tremujorin e parë.

[16] *Gjatë vitit 2017, u materializuan efektet e planit të masave të marra për reduktimin e kredive me probleme në sistemin bankar. Raporti i kredive me probleme ndaj totalit arriti në 15.6% në muajin qershor, përkundrejt 18.2%, që shënonte në muajin dhjetor 2016. Kjo rënie u ndikua më së shumti nga shlyerjet e kredive me probleme në segmentin e bizneseve.*

Grafik 15. Kredia sipas agjentëve ekonomikë dhe qëllimit të përdorimit (ndryshim vjetor)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për individë karakterizohet nga një rritje e qëndrueshme, e mbështetur si nga kërkesa në rritje, ashtu edhe nga kushtet e favorshme të kreditimit nga ana e ofertës. Ecuria e saj pozitive reflekton njëkohësisht edhe peshën më të madhe të monedhës vendase në përbërje të tij. Stoku i kredisë për individë[17] shënoi rritje mesatare vjetore prej rreth 7.5% në tremujorin e dytë të vitit. Zgjerimi i këtij portofoli është mbështetur vazhdimisht si nga kredia për konsum (12.9%), ashtu edhe nga kredia e dhënë për blerje banese (6.3%).

4.4. FINANCIMI I SEKTORIT PUBLIK

Huamarrja e qeverisë gjatë tremujorit të dytë ishte 3.1 miliardë lekë, duke e çuar huamarrjen totale të gjashtë muajve të parë të vitit në 14.2 miliardë

Grafik 16. Deficiti buxhetor dhe financimi i tij (miliardë lekë kumulative) dhe mbajtësit e borxhit të brendshëm (në përqindje ndaj totalit)*



* Në grafikun djathtas, ku pasqyrohet përbërja e borxhit të brendshëm sipas zotëruesve janë reflektuar dhe transaksionet e tregut sekondar të letrave me vlerë. Tek portofoli i individëve përfshihen dhe fondet e pensionit dhe të investimeve.

Burimi: Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë.

[17] *Të dhënat për kredinë dhënë individëve janë të rregulluara për efektin e kursit të këmbimit.*

lekë. Në ndryshim nga tremujori i parë, kur huamarrja e brendshme u krye si nëpërmjet instrumenteve afatshkurtra dhe atyre afatgjata, huamarrja e tremujorit të dytë u realizua vetëm nëpërmjet këtyre të fundit, ndërsa teprica e borxhit të kontraktuar me instrumente afatshkurtra u reduktua me 9.4 miliardë lekë.

Përbërja e borxhit publik sipas profilit të investitorëve mbetet pothuajse e pandryshuar. Në fund të tremujorit të parë, borxhi është formuar në masën 54.5% nga borxhi i brendshëm, raport ky i njëjtë me atë të një viti më parë. Stoku i borxhit të brendshëm nga ana tjetër, vijon të zotërohet në masën më të lartë (prej 58%), nga bankat e nivelit të dytë.

4.5. ECURIA E DEPOZITAVE DHE E PARASË NË EKONOMI

Oferta monetare është zgjeruar me ritme më të ngadalta gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017. Treguesi i parasë së gjerë, **agregati M3**, shënoi rritje mesatare prej 3.4% në tremujorin e dytë të vitit, nga 3.7% në tremujorin paraardhës. Zhvillimet në kahun e aktivit reflektojnë kontribut më të ulët të komponentit valutor në zgjerimin e ofertës monetare, veçanërisht në muajt maj e qershor, e lidhur kjo kryesisht me mbiçmimin e monedhës vendase ndaj dy monedhave kryesore. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe, vërehet rritje e kontributit të pretendimeve neto ndaj qeverisë, ndërsa kontributi i kredisë në zgjerimin e masës monetare mbetet i pakët. Treguesi i parasë në lekë, agregati M2, është zgjeruar gjithashtu me ritme të moderuara. Ai u rrit mesatarisht me rreth 1.8% në terma vjetorë gjatë tremujorit të dytë nga 2.1% në tremujorin e parë të vitit. Treguesi i parasë likuide, agregati M1, ka ngadalësuar normat e rritjes në 11.6%, nga 13.6% në tremujorin e parë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M2 është rritur në 34.6% në fund të periudhës, përkundrejt 34% në muajin mars.

Grafik 17. Ecuria e treguesve monetarë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Stoku i depozitave në sistemin bankar u rrit me 4.5% në terma mesatarë vjetorë, duke ruajtur normë të njëjtë rritjeje me tremujorin e kaluar. Zgjerimi i qëndrueshëm i depozitave vijon të mbështetet nga rritja më e shpejtë e depozitave në valutë (6.3%), krahasuar me atë të depozitave në lekë (2.7%). Në fund të muajit qershor, stoku total i depozitave në sistemin bankar vlerësohet të jetë rreth 71% ndaj PBB-së. Ecuria sipas agjentëve ekonomikë evidenton rritje të depozitave të biznesit, e cila tregon për shtim të likuiditetit të tyre si pasojë e përmirësimit të aktivitetit ekonomik. Nga ana tjetër, depozitat e individëve shënojnë ritme më të përmbajtura rritjeje në terma vjetorë.

Grafik 18. Ecuria e depozitave në sistemin bankar sipas monedhës dhe agjentëve ekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura kohore e depozitave ka vijuar të zhvendoset drejt depozitave pa afat. Në fund të muajit qershor, depozitat pa afat përbëjnë rreth 40.3% të stokut total të depozitave në sistemin bankar. Depozitat mbi dy vjet kanë shënuar gjithashtu rritje gjatë kësaj periudhe. Raporti i tyre ndaj depozitave totale të sistemit arriti në 8.1%, duke mbështetur zgjatjen e maturitetit mesatar të fondeve të bankave të disponueshme për ndërmjetësim.

5. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE

Inflacioni mesatar vjetor i tremujorit të dytë të vitit 2017 rezultoi 2.0%, duke shënuar një ngadalësim krahasuar me tremujorin e parë dhe me parashikimet. Reduktimi i inflacionit u shkaktua në një masë të konsiderueshme nga frenimi i presioneve të huaja inflacioniste, si pasojë e mbiçmimit të kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, presionet inflacioniste të gjeneruara nga rritja e kërkesës agregate dhe nga përmirësimi ciklik i ekonomisë, nuk arritën të kompensonin efektet nga ky faktor dhe nga zhvillime të tjera afatshkurtra në çmime gjatë tremujorit të dytë. Veprimi i kursit të këmbimit pritet të jetë më i zbehtë në pjesën e dytë të vitit 2017, ndërkohë që presionet inflacioniste nga kërkesa vlerësohet të forcohen gradualisht.

Rritja ekonomike u përshpejtua me ritme më të larta nga sa parashikohej, duke arritur në 3.9% në tremujorin e parë të vitit 2017. Rritja e kërkesës agregate, ashtu siç pritej, u mbështet nga kontributi pozitiv i të gjithë komponentëve të saj, por ndikimin kryesor e dhanë investimet, konsumi i popullatës dhe eksportet neto. Nga ana e prodhimit, zgjerimi i rritjes reale të ekonomisë, u mbështet kryesisht nga aktiviteti ndërtues dhe ai i shërbimeve. Të dhënat e disponuara për tremujorin e dytë të vitit sugjerojnë vijim të tendencave të rritjes, sipas një profili mjaft të ngjashëm me atë të tremujorit të parë, si nga ana e prodhimit ashtu edhe nga ana e shpenzimeve.

Ekonomia e vendit pritet të ndjekë trajektore rritëse të qëndrueshme për periudhën në vazhdim, duke konverguar gradualisht drejt potencialit të saj. Ky proces pritet të rrisë presionet inflacioniste afatmesme, për ta kthyer inflacionin në objektiv brenda vitit 2018.

5.1. ECURIA E INFLACIONIT

Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 2.0% në tremujorin e parë të vitit 2017, duke qëndruar 0.4 pikë përqindje më poshtë se në tremujorin paraardhës. Me gjithë

Grafik 19. Inflacioni vjetor dhe objektivi (majtas). Inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

luhatjet gjatë tremujorit të dytë, inflacioni vjetor mesatar 12-mujor ka ruajtur trajektoren rritëse të nisur në fillim të këtij viti.

Shuarja e presioneve inflacioniste të përkohshme të ushtruara nga faktorë të ofertës në muajin janar, ndikoi pjesërisht ngadalësimin e inflacionit në këtë tremujor. Krahas këtij efekti, edhe çmimet në rënie të karburanteve dhe të disa mallrave të tjera joushqimore, prodhuan kontribute të reduktuara krahasuar me ato të tremujorit të parë (-0.2 pikë përqindje).

Ecuria e inflacionit shfaqi prirje rritëse gjatë tremujorit të dytë, nga 1.9% në muajin prill në 2.2% në muajin qershor. Kjo ecuri u përcaktua nga përshpejtimi i kontributit të vërejtur në kategorinë **"Ushqime të papërpunuara"**. Kontributi i kësaj kategorie u rrit nga 0.9 në 1.6 pikë përqindje për periudhën prill-qershor. Në përgjithësi, ky tremujor shënon shtimin e ofertës për këto produkte dhe tendencë rënëse të çmimeve. Por, rënia sezonale e këtij viti rezultoi më e fortë se në vitet e tjera në muajin prill dhe mjaft më e zbutur në muajin qershor.

Kategoria tjetër e produkteve ushqimore, **"Ushqime të përpunuara"**, u karakterizua nga një normë në rënie e inflacionit vjetor krahasuar me një tremujor më parë, duke kontribuar me 0.5 pikë përqindje në inflacionin total. Kjo rënie ishte më e fortë në muajin qershor. Inflacioni i kësaj kategorie është ndikuar nga mbiçmimi i lekut, zhvillim ky që ka reduktuar kontributin rritës të inflacionit të importuar te inflacioni total. Gjithashtu, edhe koniunktura e çmimeve në tregjet botërore, në veçanti për drithërat, ka qenë në rënie krahasuar me fillimin e këtij viti.

Grafik 20. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Kontributi pozitiv i kategorisë **"Mallra të konsumit joushqimor"** u ngushtua gjatë këtij tremujori, ku rolin përcaktues e luajti tendenca rënëse e çmimeve të naftës në vend. Edhe artikujt e tjerë të kësaj kategorie, shënuan ngadalësim në terma të kontributeve. Kontribute pozitive dhe në masë të njëjtë, në inflacionin total dhanë kategoritë **"Strehim"** dhe **"Shërbime"**. Ndërkohë, kategoria **"Mallra konsumi afatgjatë"** ishte e vetmja që pati vlerë negative të kontributit (-0.1 pikë përqindjeje).

*Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)**

	T2:15	T3:15	T4:15	T1:16	T2:16	T3:16	T4:16	T1:17	T2:17
Ushqime të përpunuara (pp)	0.2	0.1	0.0	-0.4	0.1	0.4	0.6	0.6	0.5
Bukë dhe drithëra (pp)	0.0	0.0	-0.1	-0.2	-0.1	0.0	0.1	0.1	0.0
Alkool dhe duhan (pp)	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0
Ushqime të papërpunuara (pp)	1.8	1.8	2.6	1.5	0.9	1.2	0.9	1.3	1.1
Fruta (pp)	0.8	0.8	0.9	0.7	0.6	0.4	0.2	0.3	0.3
Perime(pp)	0.9	0.9	1.7	0.8	0.3	0.8	0.6	0.9	0.7
Shërbime (pp)	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.2	0.0	0.0	0.1
Mallra me çmime të rregulluara (pp)	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0
Strehim (pp)	-0.1	0.0	-0.2	-0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1
Mallra konsumi joushqimor	-0.2	-0.2	-0.3	-0.3	-0.3	-0.1	0.3	0.5	0.3
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	-0.1
Indeksi i çmimeve të konsumit (ndryshim vjetor %)	1.8	1.8	2.1	0.7	0.7	1.9	1.9	2.4	2.0

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

Zhvillimet në inflacion janë ndikuar dhe pritet të ndikohen në mënyrë edhe më të qenësishme nga forcimi i presioneve nga krahu i kërkesës së brendshme dhe nga tendenca mbyllëse e hendekut të prodhimit. Ndikimet nga faktorë tranzitorë të ofertës nuk kanë munguar, por luhatjet që kanë shkaktuar ato vlerësohet të jenë afatshkurtra, pa cenuar arritjen e objektivit të inflacionit në një horizont afatmesëm.

5.2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Sipas të dhënave të INSTAT-it, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) rezultoi me një rritje reale vjetore prej 3.9% në tremujorin e parë të vitit 2017. Norma e rritjes ka rezultuar më e ulët krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2016 (0.2 pikë përqindje), por më e lartë sesa parashikimet tona.

Në terma sektorialë, kontributi më i lartë në rritjen e PBB-së ka buruar nga sektori prodhues, i cili ka pasqyruar kryesisht performancën rritëse të aktivitetit ndërtues. Zgjerimi i aktivitetit në industri dhe në bujqësi ka ndikuar gjithashtu ecurinë ekonomike të tremujorit. Ndërkohë, sektori i shërbimeve vazhdoi të ndikojë pozitivisht rritjen ekonomike, por në një masë më të vogël se një tremujor më parë. Në terma të kërkesës agregate, rritja ekonomike ka buruar nga konsumi privat, eksportet neto dhe investimet, ku këto të fundit kanë dhënë kontribut kryesor.

5.2.1. PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE[18]

Sektori prodhues ka dhënë kontributin më të lartë në rritjen ekonomike të tremujorit të parë të vitit 2017 (prej rreth 1.8 pikësh përqindjeje). Vlera e shtuar e sektorit përshpejtoi ecurinë rritëse në 4.4%, nga 3.9% në tremujorin e mëparshëm. Vijimi i tendencës rritëse të aktivitetit në të u përcaktua kryesisht nga ecuria e **ndërtimit**, i cili kontribuoi me 1.0 pikë përqindje në rritjen ekonomike të tremujorit të parë. Edhe aktivitetet e tjera të përfshira në sektorin prodhues, si **'industria'** dhe **'bujqësia, pyjet dhe peshkimi'**, kontribuan pozitivisht, përkatësisht me 0.5 dhe 0.3 pikë përqindje, në rritjen e PBB-së. Ndërkohë, kontributi i sektorit të shërbimeve llogaritet rreth 1.6 pikë përqindje, më i ulët krahasuar me kontributin prej 2.0 pikë përqindje të dhënë një tremujor më parë. Kjo gjë reflektoi zbutjen e dinamikës rritëse të vlerës së shtuar të shërbimeve. Rritja ekonomike e tremujorit të parë u mbështet edhe nga komponenti i **taksave neto**, i cili kontribuoi pozitivisht me 0.6 pikë përqindje[19].

Grafik 21. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. *Të dhënat janë paraprake. **Një vlerësim i parë.

Vlera e shtuar e **sektorit të shërbimeve** u rrit me 3.4% në tremujorin e parë të këtij viti, një normë kjo më e ulët krahasuar me rritjen prej 4.0% të shënuar në tremujorin e fundit të vitit 2016. Norma e rritjes së sektorit vazhdon të qëndrojë mbi mesataren e vet historike (3.1%). Midis degëve të shërbimeve, vlera e shtuar e "Tregtisë, hoteleve e restoranteve dhe transportit" kontribuoi në një masë të madhe (1.1 pikë përqindje) në rritjen e sektorit, me gjithë vazhdimin e prirjes ngadalësuese. Një ndikim të njëjtë në sektorin e shërbimeve dha edhe dega e "Administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë". Kjo degë shënoi rritje vjetore me 4.2%, një normë kjo lehtësisht mbi mesataren historike. Rritja e lartë e vlerës

[18] *Ecuria e PBB-së dhe e vlerës së shtuar bruto sipas sektorëve trajtohet në terma të ndryshimeve vjetore reale. Analiza mbështetet në të dhënat më të fundit të PBB-së sipas metodës së prodhimit për tremujorin e parë të vitit 2017, të publikuara nga INSTAT-i në datën 30 qershor të vitit 2017. Diferencat midis normave të rritjes së sektorëve të këtij publikimi dhe atyre të analizuara në Raportin e Politikës Monetare 2017/II janë rezultat i rishikimit të serive.*

[19] *Kontributi i këtij komponenti pasqyroi tërësisht efektin pozitiv nga zëri i taksave mbi produktet.*

së shtuar të "Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit", me 15.8%, u përkthye në një kontribut prej rreth 0.8 pikësh përqindjeje për rritjen e sektorit. Ndërkohë, degët e "Aktiviteteve profesionale dhe shërbimeve administrative" dhe "Pasurive të paluajtshme" kontribuan përkatësisht me 0.6 dhe 0.1 pikë përqindje në rritjen e vlerës së shtuar të shërbimeve, pothuajse në të njëjtën masë si edhe në tremujorin e mëparshëm. Dinamika e degëve të "Informacionit dhe komunikacionit" dhe "Shërbimeve të tjera" rezultoi në kahun rënës, por me një ndikim të lehtë negativ (-0.2 pikë përqindje) në ecurinë vjetore të sektorit të shërbimeve.

Grafik 22. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Me gjithë rënien e treguesve të besimit në shërbime dhe në tregti në tremujorin e dytë të vitit 2017, niveli i besimit vazhdon të qëndrojë mbi mesataren historike dhe vlerën e një viti më parë, duke sugjeruar vazhdim të zhvillimeve pozitive në sektorin e shërbimeve.

Grafik 23. Ecuria e vlerës së shtuar në ndërtim dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Sektori i ndërtimit përshpejtoi ecurinë rritëse gjatë tremujorit të parë të vitit 2017. Vlera e shtuar e sektorit u zgjerua me një ritëm të lartë vjetor, rreth 14.1%, në vijim të ritmeve pozitive të tremujorit të mëparshëm[20]. Zhvillimet e sektorit u ndikuan kryesisht nga realizimi i punimeve inxhinierike dhe nga kategoria e ndërtimeve të reja[21]. Rritja e treguesve paraprijës të numrit dhe vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, u ndikua kryesisht nga kategoria e ndërtesave për qëllime banimi[22]. Gjithashtu, vazhdimi i projektit për ndërtimin e gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)[23] dhe rritja e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte vlerësohet të kenë pasur efekt pozitiv në performancën e sektorit ndërtues.

Rritja e numrit të miratuar të lejeve të ndërtimit dhe kontributi pozitiv i investimeve publike[24] sinjalizojnë për vijim të tendencës pozitive të sektorit të ndërtimit edhe në tremujorin e dytë të vitit 2017. Gjithashtu, treguesi i besimit dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim sugjerojnë se performanca e sektorit ndërtues qëndron në kahun rritës.

Grafik 24. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[20] *Një dinamikë të ngjashme të aktivitetit ndërtues paraqesin edhe të dhënat e indeksit të shitjeve neto në vëllim dhe vëllimit të prodhimit në këtë sektor. Më konkretisht, në tremujorin në analizë treguesi i shitjeve neto në vëllim për ndërtimin u rrit me 13.6% në terma vjetorë nga 7.2% në tremujorin e mëparshëm, ndërsa vëllimi i prodhimit u zgjerua me 24.2% nga 7.5% në fundin e vitit 2016.*

[21] *Zgjerimi i vëllimit të prodhimit në ndërtim i atribuohet në masën më të madhe kategorisë së punimeve inxhinierike dhe ndërtimeve të reja. Edhe ecuria e kategorisë së lidhur me rikonstruksionet rezultoi pozitive.*

[22] *Në tremujorin e parë të vitit 2017, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit shënoi rritje vjetore për ndërtesat për banim. Ndërkohë, numri i lejeve të ndërtimit të akorduara në total ishte 101 nga 147 leje të miratuara një tremujor më parë, një numër ky më i lartë krahasuar me lejet e akorduara të njëjtën periudhë një vit më parë.*

[23] *Zëra specifikë të importeve të lidhur me projektin TAP-it vazhduan ecurinë rritëse gjatë tremujorit të parë të vitit 2017.*

[24] *Referuar të dhënave paraprake të shpenzimeve kapitale të pushtetit qendror, që shënuan rritje të lartë edhe në tremujorin e dytë të vitit 2017.*

Ecuria e aktivitetit në **sektorin e industrisë** rezultoi pozitive edhe në tremujorin e parë. Vlera e shtuar e sektorit u rrit me 4.3%, një normë vjetore kjo më e ulët se rritja e shënuar në tremujorin e mëparshëm (5.5%) dhe mesatarja e saj historike (6.1%). Dinamika rritëse e këtij tremujori u formua prej kontributeve pozitive si të degës "Industri nxjerrëse, energji, ujë dhe trajtim i mbetjeve" (+2.9 pikë përqindje), ashtu edhe të degës "Industrisë përpunuese" (+1.4 pikë përqindje). Nga njëra anë, vlera e shtuar e "Industrisë nxjerrëse, energjisë, ujit dhe trajtimit të mbetjeve" ngadalësoi ritmin e rritjes vjetore në 5.6%, pas rritjes me 15.2% të shënuar një tremujor më parë. Kjo u përcaktua kryesisht nga ecuria më e ngadaltë e nëndegës së energjisë elektrike[25], pavarësisht zhvillimeve relativisht më të mira të aktivitetit të industrisë nxjerrëse[26]. Nga ana tjetër, dega e industrisë përpunuese shënoi rritje vjetore me 3.4% në tremujorin në analizë, duke ndërprerë ritmet rënëse të dy tremujorëve të mëparshëm[27].

Rritja e treguesit të besimit dhe shfrytëzimi i kapaciteteve në industri me një normë mbi mesataren historike, sugjeron për ecurinë pozitive të sektorit edhe në tremujorin e dytë të këtij viti. Gjithashtu, në këtë tremujor disa prej grupeve të eksporteve të produkteve industriale vazhduan të shënojnë rritje[28].

5.2.2. KËRKESA AGREGATE

Kërkesa agregate vazhdoi të zgjerohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, mbështetur si nga kërkesa e brendshme ashtu edhe ajo e huaj. Konsumi i popullatës, formimi bruto i kapitalit fiks dhe eksportet neto përbënë kontribuuesit kryesorë në rritje. Informacionet nga tregues të tërthortë, sugjerojnë vijim të rritjes së kërkesës agregate edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017.

Kërkesa e brendshme u zgjerua me 4.1% në tremujorin e parë të vitit 2017. Sikurse në tremujorët e kaluar, kontributet kryesore kanë buruar nga konsumi i popullatës dhe nga formimi i kapitalit. Kontribute pozitive, por më të ulëta, kanë ardhur edhe nga ana e konsumit publik. Në rastin e formimit të kapitalit, kontributet pozitive vlerësohet të jenë të lidhura kryesisht me investimet publike, por nuk ka munguar edhe prania e lartë e atyre private.

Tregues paraprijës dhe të tërthortë sinjalizojnë për vijim të rritjes së kërkesës së brendshme gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017. Kjo rritje do të ushqehet

[25] *Në tremujorin e parë të vitit 2017, indeksi i prodhimit në vëllim për degën "Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar" shënoi rënie vjetore me 28.0%, pas rritjes graduale në 3 tremujorët e mëparshëm, mesatarisht me 35.2%.*

[26] *Sipas të dhënave të indeksit të prodhimit dhe shitjeve neto në vëllim, industria nxjerrëse shënoi rritje në tremujorin e parë. Si një industri e orientuar gjerësisht nga eksportet, këto zhvillime pozitive vlerësohet të jenë ndikuar edhe nga rritja e eksporteve kryesore të lidhura me të.*

[27] *Të dhënat në vlerë të eksporteve të industrive tekstile, të veshjes, të lëkurëve dhe këpucëve, nëndega që ka edhe peshën më të lartë në industrinë përpunuese, vazhduan të shënojnë rritje, ndonëse me ritme lehtësisht më të zbutura.*

[28] *Në tremujorin e dytë të këtij viti, eksportet në vlerë për grupet "Xeherorë, zgjyra dhe hiri", "Kripëra, sulfure, okside, gëlqere dhe çimento" dhe për produktet e lidhura me industrinë tekstile, të veshjes, të lëkurëve dhe këpucëve, vijuan të regjistrojnë rritje. Ritmet e rritjes rezultuan më të zbutura për grupet e produkteve të lidhura me industrinë nxjerrëse.*

kryesisht nga konsumi i popullatës dhe nga investimet, ndërkohë që edhe të dhënat fiskale sinjalizojnë kontribute pozitive nga ana e konsumit publik.

Grafik 25. Treguesi i ndjesisë ekonomike dhe struktura e kërkesës së brendshme



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Konsumi privat vijoi rritjen në tremujorin e parë të këtij viti, por me ritme më të ngadalta se në tremujorin paraardhës. Shpenzimet konsumatore u rritën 1.9% në terma vjetorë në tremujorin e parë, ose rreth 0.2 pikë përqindje më pak se në tremujorin e katërt të vitit 2016. Rritja e konsumit privat u mbështet nga zhvillime pozitive në punësim, nga kushte të lehtësuara të kreditimit, si dhe nga ecuria pozitive e treguesit të besimit konsumator. Treguesi i besimit konsumator ka qëndruar mbi mesataren historike gjatë tre tremujorëve të fundit, duke sugjeruar për vijimin e ciklit përmirësues të konsumit privat në ekonomi.

Grafik 26. Ecuria e konsumit privat dhe e indeksit të besimit konsumator



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Rritja e konsumit privat pritet të vijojë në tremujorin e dytë të vitit, me ritme të ngjashme me ato të tremujorit e parë[29].

Grafik 27. Tregues të tërthortë sasiorë (grafiku majtas) dhe cilësorë (grafiku djathtas) për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e parë.



*Treguesit monetarë për tremujorin e parë 2017 janë përafruar nga vlerat e muajve janar dhe shkurt 2017.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Rritja e investimeve në ekonomi u përshpejtua në tremujorin e parë të vitit, duke dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e kërkesës agregate. Investimet u rritën 10.9% në terma vjetorë; rreth 5 pikë përqindje më shumë se rritja mesatare e vitit 2016 dhe rreth 7 pikë përqindje më shumë se rritja në tremujorin e katërt të vitit 2016. Bazuar në të dhëna indirekte, në shtimin e kapitalit bruto në ekonomi në tremujorin e parë ndikuan si investimet private, ashtu edhe ato publike. Faktorë që vlerësohet të kenë mbështetur rritjen e investimeve janë: përmirësimi i gjendjes financiare të bizneseve[30]; rritja e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese; kushtet e lehtësuara financiare. Gjithashtu, vijimi i projekteve të mëdha investuese me financim të huaj ka mbështetur formimin e kapitalit gjatë muajve të fundit. Rritja e numrit të lejeve të ndërtimit, si dhe e kërkesës së konsumatorëve për blerje banesash[31] kanë nxitur gjithashtu investimet në ndërtim.

Grafik 28. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore



Burimi: INSTAT.

[29] *Treguesit sasiorë që dëshmojnë për vijim të rritjes së konsumit janë: rritja e importit të mallrave ushqimore dhe ato për autovetura, rritja e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe rritja e kredisë konsumatore. Të dhëna cilësore që sinjalizojnë gjithashtu për vijim të rritjes së konsumit privat janë treguesi i besimit konsumator, i cili është përmirësuar duke qëndruar mbi mesataren historike në tremujorin e dytë; treguesit e besimit në sektorët e shërbimeve dhe të tregtisë, të cilët megjithëse regjistruan ngadalësim në tremujorin e dytë, qëndrojnë mbi mesataren historike prej katër tremujorësh radhazi.*

[30] *Informacion i derivuar nga Vrojtimet e Besimit të Bizneseve.*

[31] *Informacion i derivuar nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues pranë bankave.*

Investimet pritet të vijojnë rritjen në tremujorin e dytë, në ndikimin e vazhduar të faktorëve mbështetës të mësipërm si dhe të nxitura nga forcimi i kërkesës së brendshme e të jashtme[32].

Grafik 29. Tregues afatshkurtër të investimeve për tremujorin e parë



*Kredia për investime për tremujorin e parë të vitit 2017 është përafruar nga rritja vjetore mesatare e muajve janar dhe shkurt 2017.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[32] *Tregues të tërthortë që sugjerojnë për rritje të investimeve në ekonomi në tremujorin e dytë janë rritja e investimeve publike, rritja e importit të materialeve të cilat përdoren në sektorin e ndërtimit, si dhe përmirësimi i treguesve të besimit në industri dhe ndërtim. Në një masë më të vogël, rritja e investimeve në ekonomi është mbështetur dhe nga rritja e kredisë për investime.*

HAPËSIRË INFORMUESE 1: ECURIA E ÇMIMEVE NË TREGUN E BANESAVE[I]

Indekset e çmimit të shitjes dhe të qirasë së banesave kanë shënuar zhvillime me kahe të ndryshme gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017. Indeksi i çmimit të banesave regjistroi rënie gjatë dy tremujorëve të parë. Në tremujorin e dytë, ndryshimi vjetor real i tij ishte -11.5%. Në të kundërt, indeksi i qirasë vijoi trendin rritës, të nisur që nga tremujori i tretë i vitit 2016. Raporti çmim/qira regjistroi nivelin më të ulët që nga tremujori i parë i vitit 2015[II].

Grafik 30. Indeksi i çmimit dhe i qirasë së banesave dhe raporti i tyre



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[I] *Analiza e çmimit dhe e qirasë së banesave bazohet vetëm në informacion mbi çmimet dhe qiratë në qytetin e Tiranës.*

[II] *Ecuria e këtij raporti përmbledh në një tregues të vetëm dinamikën e përgjithshme të çmimit të tregut të banesave dhe përdoret si sinjalizues i "flluskave" të çmimit të banesave.*

KËRKESA E SEKTORIT PUBLIK DHE POLITIKA FISKALE[33]

Tabloja fiskale e tremujorit të dytë ishte e ngjashme me atë të tremujorit të parë. Politika fiskale e ndjekur gjatë gjysmës së parë të këtij viti vlerësohet të ketë prodhuar një impuls pozitiv fiskal prej 1.5% të PBB-së. Pjesa më e madhe i atribuohet dinamikës rritëse të shpenzimeve buxhetore, ndërkohë që politika e taksave ka qenë pothuajse e pandryshuar që prej fillimit të vitit 2015. Balanca buxhetore ka regjistruar vlera pozitive përgjatë gjithë periudhës, por poshtë niveleve të së njëjtës periudhë të një viti më parë. Në fund të kësaj periudhe, suficiti fiskal ishte rreth 3.0 miliardë lekë, nga 6.4 miliardë lekë në fund të tremujorit të parë të vitit.

[33] *Të dhënat fiskale për 6-mujorin i përkasin publikimit të Ministrisë së Financave të datës 21 korrik 2017.*

Grafik 31. Orientimi i politikës fiskale*



*Grafiku paraqet ndryshimin e deficitit primar të krijuar brenda një viti (shuma rrëshqitëse për 4 tremujorë) në terma të PBB-së nga e njëjta periudhë e një viti më parë. Ndryshimet në kahun pozitiv tregojnë impuls fiskal, ndërkohë që vlerat nën boshtin horizontal sugjerojnë konsolidim të financave publike.
Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të stafit të BSh-së.

Ndjekja e kursit aktual të politikës fiskale pozicionon sektorin publik si faktor mbështetës në rritjen ekonomike për vitin 2017. Kontributi pozitiv pritet të reflektohet njëherazi, si në konsum të shtuar të qeverisë dhe investime më të larta publike, ashtu edhe si ndikim më i lartë nga komponenti i taksave neto. Prania më e lartë e sektorit publik në rritjen ekonomike gjatë vitit 2017, shpjegohet pjesërisht nga rritja e pagave në sektorin shtetëror[34] dhe pjesërisht nga korrektimi i fortë fiskal që njohën financat publike një vit më parë.

Shpenzimet buxhetore në tremujorin e dytë kanë ndjekur profil të ngjashëm me atë të tremujorit të parë të vitit, duke regjistruar një normë rritjeje vjetore prej 16.6%. Sikurse dhe në tremujorin e parë, rritja e totalit të shpenzimeve

Grafik 32. Ecuria e shpenzimeve



Burimi: Ministria e Financave.

[34] *Plani buxhetor për vitin 2017 përfshiu një rritje të pagave në administratën publike me rreth 10%, duke filluar që prej muajit mars.*

u përcaktua në masën më të madhe nga shpenzimet kapitale (6.6 pikë përqindje), shpenzimet për pushtetin vendor (5.5 pikë përqindje) dhe ato për sigurimet sociale me rreth 2.9 pikë përqindje[35].

Në gjysmën e parë të vitit 2017, shpenzimet u realizuan në nivelin e 209.2 miliardë lekëve, me një rritje vjetore prej 15.5%. Shpenzimet korrente e ato kapitale për të njëjtën periudhë u rritën përkatësisht me 11.7% dhe 56% nga një vit më parë. Ecuria pozitive e shpenzimeve korrente përgjatë këtij viti është mbështetur nga të gjithë zërat përbërës[36], me përjashtim të shpenzimeve për interesa. Këto të fundit janë në rënie të vazhdueshme që prej tremujorit të dytë të vitit 2016.

Të ardhurat buxhetore në tremujorin e dytë kanë shfaqur një dinamikë të përmirësuar, duke shënuar një rritje vjetore me rreth 8.8%, nga 5.1% për tremujorin e parë të vitit 2017. Përmirësimi i ritmeve të rritjes nga tremujori i mëparshëm i atribuohet dinamikës së të ardhurave nga akcizat dhe taksat kombëtare.

Grafik 33. Ecuria e të ardhurave buxhetore



Burimi: Ministria e Financave.

Të ardhurat e realizuara gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti ishin rreth 212.2 miliardë lekë, ose 7% më të larta në terma vjetorë. Ritmet e rritjes së të ardhurave gjatë këtij viti janë përcaktuar prej të ardhurave nga taksat kombëtare, pushteti lokal, TVSh-ja e sigurimet sociale. Rritja e të ardhurave nga pushteti lokal ka formuar rreth 20% të zgjerimit të totalit të të ardhurave deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, ndër kontributet më të larta të

[35] *Shpenzimet për sigurimet sociale janë zëri me peshën më të lartë në totalin e shpenzimeve, me rreth 37.5% për 6-mujorin e parë 2017.*

[36] *Shpenzimet për personelin, ato operative, për pushtetin lokal, shpenzimet për sigurimet sociale, si edhe shpenzimet e tjera kanë kontribuuar pozitivisht në rritjen e shpenzimeve korrente.*

regjistruara në vite. Në të njëjtën kohë, të ardhurat nga taksat kombëtare[37] kanë kontribuuar në një masë relativisht të lartë në rritjen e të ardhurave totale gjatë këtij viti.

Dinamika e të ardhurave gjatë këtij viti, në ambientin e një politike tatimore pothuajse të pandryshuar, pasqyron përmirësimin e kërkesës agregate, zhvillimet pozitive në tregun e punës[38] dhe rritjen e importeve[39].

Grafik 34. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

5.2.3. KËRKESA E HUAJ DHE TREGTIA E JASHTME

Deficiti real tregtar në mallra dhe shërbime u ngushtua në tremujorin e parë të vitit 2017. Ngushtimi në terma realë vlerësohet në 7.4%. Përcaktuesi kryesor në këtë zhvillim ka qenë rritja reale vjetore e eksportit të shërbimeve me 8.3%. Kontribute të larta kanë karakterizuar edhe eksportin e mallrave, i cili u zgjerua me 27.8%. Për sa u përket importeve, totali i përgjithshëm u rrit me 5.0%, me ndikim kryesor nga rritja e importit të mallrave (6.7%). Gjithashtu, importet e shërbimeve u shtuan me 1.0% në terma realë vjetorë.

Grafik 35. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë)



Burimi: INSTAT.

[37] *Tek taksat kombëtare përfshihen zëra si renta minerare, taksa e mjedisit, taksa vjetore e qarkullimit të mjeteve, taksa mbi lojërat e fatit etj.*

[38] *Punësimi në sektorin privat jobujqësor në tremujorin e parë shënoi rritje edhe në tremujorin e parë të vitit, në linjë me rritjen prej 6.7% të të ardhurave nga sigurimet sociale. Në fund të 6-mujorit, kjo e fundit u përshpejtua në 7.9% në terma vjetorë.*

[39] *Importi i mallrave në 6-mujorin e parë të vitit u rrit me 5.6% në terma vjetorë. Të ardhurat nga TVSh-ja mbi importin e mallrave formuan në masën 84% rritjen e TVSh-së totale prej 4.7% në gjysmën e parë të vitit.*

Të dhënat mbi ecurinë e eksporteve dhe importeve të mallrave zgjaten deri në tremujorin e dytë të vitit 2017. Ato tregojnë se deficiti tregtar në mallra u ngushtua me rreth 0.4% në terma vjetorë, i ndikuar kryesisht nga rritja e eksporteve, ndërkohë që importet kontribuan në drejtim të zgjerimit të tij.

Eksporti i mallrave në vlerë u zgjerua me rreth 10.2% në nivel vjetor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017. Kontributi kryesor në këtë ecuri ka ardhur nga rritja e eksportit të kategorive "Materiale ndërtimi dhe metale" dhe "Tekstile dhe këpucë". Kontributet e eksportit të kategorisë "Ushqime, pije, duhan" u përshpejtuan në krahasim me tremujorin e parë të vitit. Në këtë rast, përcaktuesit kryesorë janë nënkategoritë: "Zarzavate", "Fruta" dhe "Ushqime të përgatitura".

E vetmja kategori që prodhoi ndikime pakësuese ishte "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike". Kjo ecuri u përcaktua gjerësisht nga zhvillimet e muajit qershor. Deri në maj, ecuria kishte rezultuar shumë premtuese si nga "Lënda djegëse" ashtu edhe nga "Mineralet". Në qershor, rënia e eksporteve si në terma vjetorë, ashtu edhe në terma mujorë, ishte mjaft e fortë, veçanërisht për "Lëndë djegëse". Në rastin e "Mineraleve", tendenca lidhet me një dinamikë pakësuese të çmimeve të huaja (të ofruara veçanërisht nga Kina) e nisur që në muajin maj. Në rastin e "Lëndës djegëse" ritmet e larta të rritjes të vërejtura që prej tremujorit të tretë të vitit të kaluar (të lidhura kryesisht me eksportet e lëndës djegëse të përpunuar) mund të kenë të bëjnë me një fenomen relativisht të përkohshëm, sesa me natyrë të qëndrueshme.

Grafik 36. Ecuria vjetore e çmimit të naftës në tregun Brent, e eksportit të naftës vendase (majtas), e indeksit të çmimit të metaleve dhe e eksportit të metaleve vendase (djathtas)



Burimi: INSTAT, FMN, EIA.

Aktiviteti importues rezultoi me një rritje prej 7.5% në terma vjetorë, i përqendruar kryesisht në muajin mars. Kontributet kryesore pozitive burojnë nga kategoritë "Ushqime, pije, duhan", "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike", "Tekstile dhe këpucë". Kontributet negative lidhen kryesisht me kategoritë "Materiale ndërtimi dhe metale" dhe pjesërisht me kategorinë "Makineri, pajisje, pjesë këmbimi".

Sipas orientimit gjeografik, vendet e Bashkimit Evropian dhe veçanërisht Italia mbeten partnerët kryesorë tregtarë si për eksportet, ashtu edhe për importet. Pesha e Kinës ka pësuar rënie gjatë muajve të fundit si pasojë e rënies së eksportit të mineraleve drejt këtij destinacioni. Nga ana tjetër, vihet re një diversifikim më i lartë në partnerët e eksportit të lëndës djegëse. Një pakësim është vënë re edhe në pesha e Maqedonisë dhe Serbisë gjatë dy muajve të fundit.

HAPËSIRË INFORMUESE 2: ZHVILLIMET NË BILANCIN E PAGESAVE NË TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2017

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 179.3 milionë eurosh në tremujorin e parë të vitit 2017, duke u ngushtuar me rreth 19.9% në nivel vjetor. Ai u vlerësua në nivelin 6.9% ndaj PBB-së nominale, rreth 2.4 pikë përqindjeje më ulët se në të njëjtin tremujor të një viti më parë. Përcaktues në këtë dinamikë ka qenë zgjerimi i eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve me rreth 26.8% në nivel vjetor, ndikuar në masë të madhe nga rritja në terma vjetorë e eksportit të shërbimeve me 22.2%.

Gjithashtu, eksporti i mallrave u zgjerua me rreth 44.6%. Importi i përgjithshëm u rrit me rreth 7.2% në terma vjetorë me kontribute kryesore nga importi i mallrave, i zgjeruar me rreth 9.0%, krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, importi i shërbimeve është shtuar me 3.1%. Remitancat neto rezultuan rreth 0.1% më të larta në terma vjetorë. Përsa i përket llogarisë së të ardhurave parësore, teprica rezultoi -35.8 milionë euro, ndërkohë që një vit më parë shënonte 10.4 milionë euro. Ndikimi kryesor në këtë drejtim lidhet me zhvillimet në llogarinë e të ardhurave nga investimet.

Në rastin e llogarisë financiare, flukset hyrëse të investimeve direkte neto u zgjeruan në terma vjetorë me 17.6%. Në terma të financimit të deficitit korrent, sipas profilit të flukseve, flukset joborxhkrijuese kanë qenë ato me kontribut kryesor, ndërkohë që janë shtuar edhe flukset borxhkrijuese. Mjetet e rezervës janë shtuar me 8.6 milionë euro.

Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)

	T3'15	T4 '15	T1 '16	T2 '16	T3'16	T4'16	T1'17
Llogaria korrente (në mil euro)	-312.7	-397.7	-223.8	-359.6	-206.1	-240.3	-179.3
vmv (%)	5.7	4.0	-3.1	120.3	-34.1	-39.6	-19.9
/ PBB-së (%)	-12.2	-14.8	-9.3	-12.9	-7.7	-8.4	-6.9
Mallra dhe shërbime	-476.3	-564.5	-403.3	-555.1	-410.9	-436.9	-313.3
vmv (%)	1.3	4.4	8.2	54.0	-13.7	-22.6	-22.3
Eksporte, f.o.b.	785.0	714.7	608.5	717.2	926.8	857.0	771.8
vmv (%)	-2.3	-0.7	2.5	1.6	18.1	19.9	26.8
Importe, f.o.b.	1261.4	1279.1	1011.9	1272.3	1337.6	1293.8	1085.1
vmv (%)	-1.0	1.5	4.7	19.3	6.0	1.1	7.2
Udhëtime neto	64.5	51.6	67.3	72.8	153.1	95.7	75.6
Të ardhura parësore	-12.8	-34.2	10.4	-21.3	-5.5	-27.8	-35.8
Kredi	40.0	43.9	50.8	38.1	42.5	45.7	41.6
Debi	52.8	78.1	40.3	59.4	48.0	73.5	77.4
Të ardhura neto nga Investimet Direkte	-27.7	-31.7	-3.8	-30.5	-21.3	-29.8	-51.5
Të ardhura dytësore	176.4	201.0	169.1	216.8	210.3	224.4	169.8
Kredi	219.1	247.2	205.0	250.1	250.7	255.4	199.1
Debi	42.6	46.2	35.9	33.2	40.5	31.0	29.3
Dërgesa nga emigrantët -neto	139.7	153.9	135.7	153.8	159.6	165.4	135.9
vmv (%)	-15.4	-10.0	-4.2	-4.8	14.2	7.4	0.1
Llogaria Kapitale	45.6	32.8	6.6	7.2	3.1	49.4	23.8
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-267.1	-364.8	-217.3	-352.4	-203.1	-190.9	-155.6
Llogaria financiare	-126.6	-243.3	-170.5	-255.2	-90.0	-149.2	-254.0
vmv (%)	-30.9	-16.8	4.3	44.1	-28.9	-38.7	49.0
/ PBB-së (%)	-4.9	-9.1	-7.1	-9.1	-3.4	-5.2	-9.8
Investime direkte	-248.1	-120.0	-148.1	-233.6	-295.8	-280.9	-174.1
vmv (%)	2.4	-46.1	-41.7	18.9	19.2	134.0	17.6
Investime portofoli	-11.2	-172.1	106.0	-10.9	0.6	108.9	-126.2
Derivativë financiarë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	-179.7	-120.3	-78.8	-10.8	261.3	-130.5	37.6
Mjetet e rezervës	312.5	169.1	-49.6	0.0	-56.1	153.3	8.6
Gabime dhe harresa	140.5	121.5	46.7	97.2	113.1	41.8	-98.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.3. GJENDJA CIKLIKE E EKONOMISË DHE PRESIONET E BRENDSHME INFLACIONISTE

Vijimi i dinamikës pozitive të kërkesës së brendshme ka ndihmuar në ngushtimin e hendekut negativ të prodhimit. Zhvillimet aktuale dhe të pritshme sugjerojnë se pozicioni ciklik i ekonomisë po përmirësohet, pavarësisht pranisë së kapaciteteve të lira në tregun e punës dhe të kapitalit. Konvergimi i ekonomisë drejt potencialit do të ushtrojë presione në kahun rritës për pagat dhe kostot e tjera prodhuese, duke kontribuuar në kthimin e inflacionit në objektiv në afat të mesëm.

Zhvillimet pozitive në kërkesën e brendshme kanë vijuar të ushtrojnë presione drejt ngushtimit të hendekut të prodhimit, ndonëse ky i fundit vlerësohet në territor negativ edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2017. Sipas rezultateve të vrojtimit të besimit, bizneset në ekonomi vlerësojnë të kenë shfrytëzuar kapacitetet prodhuese me një normë mesatare rreth 70.8%[40] në tremujorin e dytë të këtij viti. Treguesi qëndron nën mesataren historike të tij me rreth 3 pikë përqindje, duke sugjeruar praninë e kapaciteteve të lira në ekonomi. Me gjithë luhatjet e fundit afatshkurtra, pirja e tij drejt afrimit te mesatarja afatgjatë, e nisur nga fundi i vitit 2015, pritet të vijojë, në reflektim të zhvillimeve pozitive në rritjen e kërkesës agregate.

Grafik 37. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë*



*Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve mbi të cilën është aplikuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve është llogaritur si devijim i vlerës aktuale nga mesatarja përkatëse historike, dhe më pas është zbatuar metoda e mesatares lëvizëse me katër terma. Hendeku i shkallës së papunësisë vlerësohet si devijim i shkallës ekuilibër të papunësisë me vlerën aktuale të saj, dhe më pas është zbatuar metoda e mesatares lëvizëse me katër terma.
Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimet në tregun e punës rezultuan pozitive edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2017. Treguesi i punësimit në ekonomi shënoi rritje, por me ritme më të zbutura[41]. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i të punësuarve u rrit me 3.5%, pas rritjes me 5.5% në tremujorin e fundit të vitit 2016. Ndërkohë, ecuria tremujore e punësimit rezultoi pozitive, rreth 0.2%,

[40] *Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2017, treguesi i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve analizohet i rregulluar për sezonalitet.*

[41] *Analiza e punësimit dhe e papunësisë mbështetet në të dhënat e Anketës Tremujore të Forcave të Punës dhe i referohet treguesve për popullsinë me moshë 15 vjeç e lart.*

pas rënies me 1.4% një tremujor më parë[42]. Punësimi në sektorin e shërbimeve vlerësohet të ketë dhënë kontributin më të lartë në rritjen vjetore të punësimit në ekonomi. Ndikimi pozitiv i këtij sektori u zbeh nga tkurrja e punësimit në sektorin bujqësor (-0.9%) dhe rritja më e ngadaltë e punësimit në sektorin e industrisë (me 3.0% nga 5.1% në tremujorin e katërt të vitit 2016).

Shkalla e papunësisë rezultoi rreth 14.2% në tremujorin e parë të këtij viti, sa niveli i shënuar një tremujor më parë dhe rreth 2.4 pikë përqindje poshtë vlerës së shënuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vlerësimet tregojnë se hendeku i papunësisë[43] vazhdon të jetë negativ, por me një prirje ngushtuese, e cila pritet të shtojë presionet rritëse për pagat në ekonomi.

Treguesi i kostove të punës për njësi[44] vazhdoi të ngadalësojë prirjen rritëse edhe në tremujorin e parë të vitit 2017, duke shënuar rritje me 1.8%, pas rritjes me 3.4% një tremujor më parë. Kjo ecuri pasqyroi frenimin e tendencës përmirësuese të pagës mesatare reale për aktivitetet e mbuluara nga statistikat afatshkurtra, të kombinuar me zbutjen e dinamikës rënëse të produktivitetit të punës. Këto zhvillime sugjerojnë se tregu i punës nuk ka përçuar ende sinjale të forta rritëse për presionet inflacioniste të brendshme. Ndërkohë, kostot prodhuese në industri u rritën me rreth 5% në tremujorin e parë[45], një ritëm i lartë kundrejt vlerës 0.9% të tremujorit të mëparshëm. Kostot prodhuese në ndërtim[46] vijuan rritjen vjetore në tremujorin e parë të vitit 2017, e cila megjithëse modeste (1.0%), ishte më e lartë se në tremujorin paraardhës (0.4%).

Grafik 38. Ndryshimet vjetore mesatare të sheshuara të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit*



*Mbi ndryshimet vjetore të treguesve, janë zbatuar mesataret lëvizëse me 4 terma, për të zbutur luhatjet e rastit.
Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Vijimi i prirjeve ngushtuese në hendekët e prodhimit dhe të normës së papunësisë nuk u reflektuan në drejtimin dhe në intensitetin e pritur tek komponentët e inflacionit përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2017. Ngadalësimi i përgjithshëm i inflacionit u gjenerua kryesisht nga përbërësit afatshkurtër dhe me origjinë të huaj. **Inflacioni bazë dhe ai i mallrave të patregtueshme** të shportës së IÇK-së,

[42] *Numri i të punësuarve me frekuencë tremujore nga Anketa e Forcave të Punës ka filluar të publikohet që nga tremujori i parë i vitit 2012. Seria e agreguar nuk shfaq sezonalitet, e si rrjedhojë, ndryshimet tremujore llogariten mbi serinë e parregulluar për sezonalitet.*

[43] *Llogaritet si diferencë e shkallës ekuilibër të papunësisë (mesatare e vlerësimeve NAIRU dhe NAWRU), me shkallën faktike të papunësisë.*

[44] *Treguesit përafrues të produktivitetit të punës dhe të kostove të punës për njësi të prodhuar, llogariten nga Banka e Shqipërisë, duke përdorur seritë totale të Statistikave Afatshkurtra (SASH, INSTAT, T1'17). Në përllogaritjen e tyre përfshihen: indekset e numrit të të punësuarve me pagesë, të shitjeve neto në vëllim dhe të fondit të pagave për totalin e aktiviteteve të mbuluara nga anketa e SASh. Normat e raportuara të rritjes i referohen mesatares rrëshqitëse me katër terma të ndryshimeve vjetore të treguesit.*

[45] *Kjo rritje mbart edhe efektin e bazës së ulët krahasuese të një viti më parë (-4%).*

[46] *Indeksi i kushtimit në ndërtim për banesa përfshin çmimet e materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe shpenzimeve të tjera kapitale, që përdoren për ndërtimin e një banese tip 8 – 10 kate.*

rezultuan përkatësisht, 0.9% dhe 1.6%. Dinamikat më të përmbajtura në rritjen e çmimeve të disa prej mallrave ushqimore, të disa mallrave të tjera me afat të gjatë përdorimi dhe të disa shërbimeve, prodhuan kontribute më të ulëta se në tremujorin e kaluar për inflacionin total. Efekti i mbiçmimit të monedhës vendase vlerësohet të ketë përçuar gjithashtu zhvillime frenuese edhe për inflacionin bazë, i cili nuk mbeti i izoluar prej tyre. Presionet inflacioniste në këtë tremujor u frenuan edhe nga zhvillimet në **inflacionin jobazë dhe në atë të artikujve të tregtueshëm** të shportës së IÇK-së. Ata shënuan përkatësisht vlerat 4.9% dhe 2.4%, më të ulëta se në tremujorin e kaluar. Vlerësohet se intensitetin më të lartë në reduktimin e inflacionit total e ka dhënë komponenti i tregtueshëm, i ndikuar nga sjellja mbiçmuese e monedhës vendase.

Grafik 39. Prirjet afatgjata të inflacionit (majtas) dhe prirjet afatshkurtra (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimet pozitive në tregun e prodhimit të mallrave dhe të shërbimeve pritet të materializohen më dukshëm në forcim të presioneve inflacioniste nga kërkesa e brendshme, nëse vijojnë përmirësimet në tregun e punës.

5.4. INFLACIONI I IMPORTUAR

Presionet e përgjithshme inflacioniste u ngadalësuan kryesisht nga reduktimi i kontributit të inflacionit të importuar krahas zhvillimeve të përmbajtura nga ana e inflacionit të brendshëm. Inflacioni i importuar vlerësohet të ketë dhënë një kontribut prej 0.8 pikë përqindjeje në inflacionin total të tremujorit të dytë të vitit 2017 ose 0.4 pikë përqindje më pak sesa në tremujorin e kaluar. Ky zhvillim është paraprirë nga ecuria e Treguesit të Presioneve të Huaja Inflacioniste (TPHI)[47]. TPHI-ja u ngushtua mesatarisht me 0.3% në terma vjetorë gjatë

[47] *TPHI-ja llogaritet si rritja vjetore e indeksit të çmimeve të huaja dhe indeksit KNEK për muajin përkatës. Presionet inflacioniste me origjinë të huaj vlerësohet që ndikojnë inflacionin vendas me rreth 1-3 muaj vonesë.*

periudhës prill-maj, i ndikuar, nga njëra anë, nga efektet rritëse të indeksit të "çmimeve të huaja"[48], i cili u zgjerua mesatarisht me 4.1% në terma mesatarë vjetorë me kontribute pozitive nga pothuaj të gjithë partnerët e përfshirë. Nga ana tjetër, mbiçmimi i kursit nominal efektiv të këmbimit (mesatarisht me 4.2% gjatë të njëjtës periudhë), frenoi përçimin e efekteve të çmimeve të huaja tek TPHI-ja.

Grafik 40. Kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (majtas). TPHI-ja dhe kontributet e përbërësve të tij (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Me gjithë ngadalësimin e inflacionit në këtë tremujor, rolin përcaktues në formimin e tij vijoi ta mbajë **inflacioni i brendshëm**.

[48] *Është një tregues përafrues mbi presionet e huaja inflacioniste, i krahasueshëm me inflacionin e sektorit të tregtueshëm të mallrave të shportës së IÇK-së vendase. Indeksi i çmimeve të huaja bazohet në vlerat: e inflacionit të kategorisë "Ushqim, pije, duhan" për 18 shtete kryesore; dhe inflacionit të "Mallrave" (pra, jo vetëm Ushqime) për Bullgarinë, Gjermaninë, Greqinë, Italinë dhe Turqinë. Disa nga mallrat kanë shënuar rritje vjetore të çmimeve, ndërsa janë rritur edhe peshat e importeve me shtetet përkatëse. Kjo ka ndikuar që vlera përfundimtare e treguesit (mesatare e ponderuar e IÇK-ve të lartpërmendura me peshat mujore të importit të tyre), të shënojë një rritje jo pak të rëndësishme.*

HAPËSIRË INFORMUESE 3[I]: NDIKIMI I MBIÇMIMIT TË KURSIT TË KËMBIMIT NË INFLACION

Monedha vendase ka shfaqur një prirje mbiçmuese në raport me monedhat e vendeve kryesore partnere gjatë periudhës shtator 2015 - qershor 2017. Në terma efektivë nominalë (NEER), mbiçmimi mesatar vjetor rezulton rreth 3.1% për periudhën e lartpërmendur. Intensiteti i mbiçmimit ka ardhur në rritje: nga 3.3% në vitin 2016, në 4.2% për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017. Mbiçmimi i lekut kundrejt euros, ka qenë kontribuuesi kryesor në këtë zhvillim për nga vetë pesha e madhe (rreth 80%) që kjo monedhë zë në shportën e monedhave kryesore. Leku është mbiçmuar mesatarisht me 1.7% dhe 2.3% kundrejt euros, përkatësisht gjatë vitit 2016 dhe gjatë 6 muajve të parë të vitit 2017.

Grafik 41. Ecuria e ndryshimeve vjetore të NEER (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kjo sjellje vlerësohet të ketë frenuar presionet e përgjithshme inflacioniste në ekonomi. Më poshtë paraqiten disa vlerësime sasiore të ndikimit të mbiçmimit të kursit të këmbimit në inflacion. Ndikimi i kursit të këmbimit në inflacion mund të përcillet në disa kanale, por dy më kryesoret janë: (i) kanali i drejtpërdrejtë, nëpërmjet të cilit mbiçmimi i kursit të këmbimit përkthehet në uljen e çmimeve të importit për mallrat e importuara, të cilat janë pjesë përbërëse e shportës së konsumit; dhe, (ii) kanali i tërthortë, nëpërmjet të cilit, mbiçmimi i kursit të këmbimit ndikon negativisht konkurrueshmërinë e produkteve tona, çka sjell më tej një rritje më të ulët ekonomike, për pasojë dobësim të presioneve inflacioniste dhe devijim të inflacionit nga objektivi.

Ndikimet e kursit në inflacion janë vlerësuar nëpërmjet disa përqasjeve ekonometrike të disponuara në Bankën e Shqipërisë, të cilat variojnë nga përdorimi i koeficientit të përçimit të efektit të kursit në inflacion, sipas një vlerësimi VAR[II], tek modelet e parashikimit afatshkurtër të inflacionit total dhe atij bazë[III]. Bazuar në këto përqasje, rezulton se mbiçmimi i kursit të këmbimit ka dhënë një ndikim mesatar në uljen e inflacionit që luhatet në intervalin nga -0.12 pikë përqindjeje në fillim të vitit 2016 në -0.33 pikë përqindje në mesin e vitit 2017. Sipas koeficientit të përçimit me anë të përqasjes VAR, ndikimi mesatar vlerësohet rreth një reduktimi prej -0.2 pikë përqindje në inflacion. Rezultate të ngjashme arrihen edhe nga vlerësimet e modeleve të parashikimit afatshkurtër të inflacionit. Ato tregojnë se intensiteti frenues në inflacion ka ardhur në rritje nga viti 2016 në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017. Të dyja përqasjet konvergojnë në përfundimin se presionet inflacioniste janë frenuar për shkak të sjelljes mbiçmuese të monedhës vendase në terma nominalë efektivë, duke reduktuar inflacionin total mesatarisht me 0.2 pikë përqindje, gjatë periudhës janar 2016 - qershor 2017.

Vlerësimet e mësipërme mesatarizojnë sjelljen e kursit të këmbimit kundrejt ndikimit në inflacion. Reagimi i inflacionit kundrejt luhatjeve të kursit të këmbimit nuk është i njëjtë si ndaj mbiçmimit, ashtu edhe ndaj nënçmimit. Përçimi mund të ketë intensitet të ndryshueshëm në kohë dhe madhësi sipas situatave të ndryshme. Studime të ndryshme tregojnë[IV] se inflacioni në ekonominë tonë është mjaft më sensitiv kundrejt nënçmimit të monedhës vendase, ndërkohë që sjelljet mbiçmuese përcillen me intensitet më të përmbajtur në çmimet e konsumit.

Grafik 42. Ndikimi i drejtpërdrejtë i mbiçmimit të kursit të këmbimit për periudhën janar 2016 – qershor 2017, sipas muajve



Burimi: Vlerësime të autorëve.

Sjellja mbiçmuese e kursit, në harkun kohor të një viti e gjysmë, në periudha të caktuara është reflektuar në ngadalësim më të fortë të inflacionit total. Kjo është bërë më e dukshme për shkak se mbiçmimi vlerësohet se ka prekur edhe komponentë të inflacionit, relativisht më të izoluar kundrejt luhatjeve të kursit të këmbimit.

Kështu, presionet afatgjata nuk kanë qenë krejtësisht të imunizuara nga efekti i mbiçmimit të monedhës vendase. Artikuj të caktuar të nënshportës mbi të cilën matet inflacioni bazë, janë ndikuar nga sjellja e akumuluar mbiçmuese e monedhës vendase. Kjo e fundit ka shkaktuar ngadalësimin e inflacionit bazë, kryesisht gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017. Ngadalësimi është kombinuar me natyrën e lartë persistente të komponentit afagjatë të inflacionit, duke amplifikuar efektin frenues në inflacion nga mbiçmimi i monedhës vendase. Nga ana tjetër, efekt rritës për inflacionin bazë ka dhënë sjellja mbyllëse e hendekut të prodhimit.

Grafik 43. Dekompozimi i hendekut të inflacionit bazë sipas: hendekut të NEER; hendekut të prodhimit



Burimi: Vlerësime të autorëve.

Vlerësimet tregojnë se rritja graduale e inflacionit bazë e shprehur në zvogëlim të devijimit ndërmjet inflacionit bazë dhe objektivit 3% të inflacionit, është ndikuar nga sjellja drejt mbylljes graduale të hendekut negativ të prodhimit gjatë periudhës T3'16 - T2'17. Por nga ana tjetër, mbiçmimi i kursit të këmbimit në T2'17, ka tërhequr për poshtë edhe inflacionin bazë.

Në përfundim do të cilësohej se efekti mesatar i mbiçmimit të kursit të këmbimit në reduktimin e inflacionit vlerësohet rreth 0.2 pikë përqindje, për periudhën në analizë. Ndërkohë që duke e konsideruar kursin e këmbimit një faktor me veprim shumë më tranzitor sesa hendeku i prodhimit në inflacionin bazë, vlerësohet se janë pikërisht zhvillimet pozitive në mbylljen e hendekut të prodhimit, që do

të japin impulse rritëse në presionet afatgjata inflacioniste dhe në kthimin e inflacionit në objektiv.

I *Hapësira informuese u përgatit nga Evelina Çeliku (sipas vlerësimeve të përditësuara në korrik 2017).*

II *Istrefi & Semi (2009), "Përçimi i kursit të këmbimit në Shqipëri: Evidencë nga vektorët autoregresivë". Rezultatet e kësaj pune janë përditësuar nga Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, viti 2015.*

III *Çeliku dhe Hashorva (2012), "Vlerësimi i performancës parashikuese: pasiguritë në parashikimin e inflacionit", Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë, 01(51)2012; Çeliku dhe Hashorva (2013), "Performanca e parashikimit të inflacionit dhe vendimmarrja e politikës monetare gjatë periudhës 2011-2012", Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë, 09(68)2013. Në këto materiale trajtohen modelet ekonometrike që përdoren në Bankën e Shqipërisë për parashikime afatshkurtra të inflacionit total, bazë etj., përqasje (edhe me pjesëmarrjen e kursit të këmbimit NEER, si një variabël shpjegues që hyn në modele me vonesa kohore të caktuara).*

IV *Kolasi, Çeliku dhe Harshova, (2001), "Tendenca e inflacionit në Shqipëri gjatë dekadës së kaluar. Një vështrim empirik", Buletini ekonomik, Vëllimi 4, Nr.4, Banka e Shqipërisë. https://www.bankofalbania.org/web/Buletini_ekonomik_Vellimi_4_Nr_4_Tendenca_e_inflacionit_ne_Shqiperi_gjate_dekades_se_kaluar_Nje_veshtrim_empirik_1971_1.php*
Peters, M (2005) "What about Monetary Transmission mechanism in Albania? Is the exchange rate pass-through (still) the main channel? Fifth Annual Conference of Bank of Albania. https://www.bankofalbania.org/web/pub/M_PETERS_1328_1.pdf

5.5. PRITJET PËR INFLACIONIN[49]

Pritjet inflacioniste afatshkurtra janë rishikuar për poshtë në tremujorin e dytë të vitit 2017, duke iu përshtatur tendencës rënëse të vlerave të publikuara të inflacionit sipas muajve të tremujorit të parë. Pritjet inflacioniste afatmesme të agjentëve financiarë nuk kanë ndryshuar nga niveli i shënuar një tremujor më parë.

Pritjet afatshkurtra të **konsumatorëve** u rishikuan për poshtë, me 0.4 pikë përqindje, në tremujorin e dytë. Aktualisht niveli i tyre qëndron 0.9 pikë përqindje nën mesataren historike të serisë. Pritjet afatshkurtra të **bizneseve** u rishikuan gjithashtu për poshtë, me 0.1 pikë përqindje. Sipas sektorëve, rishikimi për poshtë u regjistrua kryesisht në bizneset e shërbimeve, me 0.3 pikë përqindje. Pritjet e sektorëve të industrisë dhe të ndërtimit u luhatën më pak, ndërsa ato të biznesit të sektorit të tregtisë regjistruan rritje. Pritjet e **agjentëve financiarë** pas një dhe dy vitesh janë rishikuar gjithashtu për poshtë me përkatësisht 0.4 dhe 0.2 pikë përqindje.

Pritjet afatmesme (pas tre vitesh) janë më të qëndrueshme dhe më pak të ndikuara nga luhatjet afatshkurtra të inflacionit duke mbetur më të ankoruara

[49] *Analiza mbi pritjet inflacioniste bazohet në rezultatet e vrojtimit të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve, si dhe në vrojtimin e pritjeve të agjentëve financiarë.*

pranë objektivit 3% të inflacionit. Niveli i tyre mesatar gjatë dy tremujorëve të fundit ka shënuar vlerën 2.7%.

Grafik 44. Pritjet inflacioniste të bizneseve dhe të konsumatorëve (grafiku majtas) dhe të agjentëve financiarë (grafiku djathtas), ndryshime vjetore në përqindje



Burimi: Departamenti i Politikës Monetare.

SHTOJCA STATISTIKORE		STATISTICAL APPENDIX
	Fq	
TREGUES TË PËRGJITHSHËM MAKROEKONOMIKË	60	MAIN MACROECONOMIC INDICATORS
1. Zhvillimet monetare dhe normat e interesit	60	Monetary developments and interest rates 1.
2. Prodhimi i brendshëm bruto, indekset e çmimeve dhe tregu i punës	60	Gross domestic product, price indexes and labor market 2.
3. Bilanci i pagesave, rezerva dhe kursi i këmbimit	61	Balance of payments, reserves and exchange rate 3.
4. Bilanci fiskal, stoku i borxhit të brendshëm dhe borxhi i jashtëm	61	Fiscal balance, domestic debt stock and external debt 4.
1 SEKTORI FINANCIAR	62	FINANCIAL SECTOR 1
1-1 Bilanci sektorial i Bankës së Shqipërisë	62	Sectoral balance sheet of Bank of Albania 1-1
1-2 Paraqitja monetare e Bankës së Shqipërisë	63	Monetary survey of Bank of Albania 1-2
1-3.a Bilanci sektorial i bankave paradepozitiese/ Mjetet	64	Sectoral balance sheet of deposit money banks/ Assets 1-3.a
1-3.b Bilanci sektorial i bankave paradepozitiese/ Detyrimet	65	Sectoral balance sheet of deposit money banks/ Liabilities 1-3.b
1-4 Paraqitja monetare e bankave paradepozitiese	66	Monetary survey of deposit money banks 1-4
1-5 Bilanci sektorial i shoqërive të kursim-kreditit	67	Sectoral balance sheet of savings and loan associations 1-5
1-6 Paraqitja monetare e korporatave të tjera depozitiese	68	Monetary survey of other depository corporations 1-6
1-7 Paraqitja monetare e korporatave depozitiese	69	Monetary survey of depository corporations 1-7
1-8.a Agregatët monetarë dhe përbërësit e tyre	70	Monetary aggregates and their components 1-8.a
1-8.b Kundërpartitë e agregatëve monetarë	71	Counterparts of monetary aggregates 1-8.b
1-9 Depozitat në lekë sipas sektorëve	72	Lek denominated deposits by sectors 1-9
1-10 Depozitat në valutë sipas sektorëve	72	Foreign currency denominated deposits by sectors 1-10
1-11 Kredia për ekonominë sipas sektorit	73	Credit to economy by sector 1-11
1-12.a Huatë e korporatave jofinanciare sipas aktivitetit ekonomik	73	Loans of non-financial corporations by economic activity 1-12.a
1-12.b Huatë e korporatave jofinanciare sipas aktivitetit ekonomik	74	Loans of non-financial corporations by economic activity 1-12.b
1-13a Huatë e korporatave jofinanciare private sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	75	Private non-financial corporations loans by purpose and currency 1-13a
1-13b Huatë e korporatave jofinanciare publike sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	76	Public non-financial corporations loans by purpose and currency 1-13b
1-14 Huatë e Individëve dhe Institucioneve jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	77	Households + Non-profit institutions serving households loans by purpose and currency 1-14
1-15 Huatë sipas rretheve	78	Loans by districts 1-15
1-16 Normat e interesit të Bankës së Shqipërisë	79	Bank of Albania interest rates 1-16
1-17 Normat e interesit për depozitat e reja të korporatave jo-financiare, individëve dhe institucioneve jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas monedhave	80	Interest rates on new deposits of non-financial corporations, households and NPISH by currency1-17
1-18 Normat e interesit për huatë e reja të korporatave jo-financiare, individëve dhe institucioneve jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas monedhave	81	Interest rates on new loans of non-financial corporations, households and NPISH by currency 1-18
1-18a Normat e interesit për huatë e reja të e korporatave jofinanciare private sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	82	Average monthly interest rates for new loans to private non-financial corporations by purpose and currency 1-18a
1-18b Normat e interesit për huatë e reja të individëve dhe institucioneve jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve, sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	83	Average monthly interest rates for new loans to households and NPISH by purpose and currency 1-18b
1-19 Normat e interesit për bonot e thesarit sipas afatit	84	Maturity breakdown of Treausury bills yields 1-19
1-20 Sistemi i pagesave ndërbankare	85	Interbank payment system 1-20
1-21 Shpërndarja rajonale e terminaleve të ATM & POS	85	Number of ATM & POS terminals by region 1-21
1-22 Numri i llogarive të klientëve në banka	85	Number of customers accounts with banks 1-22
2 SEKTORI I JASHTËM	86	EXTERNAL SECTOR 2
2-1 Bilanci i Pagesave	86	Balance of payments 2-1
2-2 Kurset e këmbimit të lekut kundrejt monedhave kryesore	87	Exchange rate 2-2
2-3 Eksporti sipas grup mallrave	87	Export by commodity groups 2-3
2-4 Importi sipas grup mallrave	88	Import by commodity groups 2-4
2-5 Borxhi i jashtëm bruto	88	Gross external debt 2-5
3 SEKTORI FISKAL	89	FISCAL SECTOR 3
3-1 Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar	89	Fiscal indicators regarding consolidated budget 3-1
3-2 Stoku i borxhit të brendshëm sipas instrumenteve	89	Domestic debt stock by instruments 3-2
4 SEKTORI REAL	90	REAL SECTOR 4
4-1 Prodhimi i brendshëm bruto sipas klasifikimit të aktivitetit ekonomik	90	Gross domestic product by economic activities 4-1
4-2 Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim	91	Producer price index and construction cost index 4-2
Ndryshimet në % të indeksit të çmimeve të prodhimit dhe të indeksit të kushtimit në ndërtim 3)	91	Change in % of producer price index and construction cost index 3)
4-3 Indeksi i çmimeve të konsumit	92	Consumer price index 4-3
4-4 Punësimi, papunësia dhe pagat	93	Employment, unemployment and wages 4-4

TREGUES TË PËRGJITHSHËM MAKROEKONOMIKË
1. ZHVILLIMET MONETARE DHE NORMAT E INTERESIT
Në miliardë lekë, përveç rasteve kur shënohet ndryshe, fund periudhe

MAIN MACROECONOMIC INDICATORS
MONETARY DEVELOPMENTS AND INTEREST RATES 1.
In billions ALL, unless otherwise indicated, end of period

	Agregatët monetarë / Monetary aggregates			Depozitat[2]/ Deposits[2]	Kredia3 / Credit3	Normat e interesit 12m / 12m interest rates (%)			Norma e marrëveshjes së riblerjejes njëjavore [5] / Weekly repurchase agreement rate[5]
	M1	M2	M3			Depozita[4] / Deposits[4]	Hua [4] / Loans[4]	Bono Thesari/ T. Bills	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2013	295.9	693.2	1,149.0	950.1	547.9	4.17	9.52	3.66	3.00
2014	353.3	722.4	1,195.1	977.4	560.0	1.92	7.66	3.33	2.25
2015 [1]	384.1	723.0	1,216.2	985.6	546.8	1.35	7.79	2.40	1.75
2016	435.4	736.9	1,263.5	1,014.0	547.2	0.80	5.89	2.92	1.25

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO[6], INDEKSET E ÇMIMEVE DHE TREGU I PUNËS

GROSS DOMESTIC PRODUCT[6], PRICE INDEXES AND LABOR MARKET 2.

	Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante (%)/ Annual real growth of GDP at constant prices (%)	Me çmime korrente, në milionë lekë [7] / At current prices, in million ALL [7]				Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të konsumit (%) / Yearly changes in CPI (%)	Ndryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit (NVE Rev.2) % Average Annual Changes of Producer Price Index (NACE Rev.2) %	Tregu i punës[7] / Labor market[7]	
		Produkti Brendshëm Bruto (PBB) / Gross domestic product (GDP)	Pagat e të punësuarve, neto /Compensation of employees, net	Të Ardhura nga prona, neto / Property income, net	Të Ardhurat Kombëtare Bruto / Gross National Income			Shkalla e punësimit / Employment rate (%)	Shkalla e papunësisë / Unemployment rate (%)
	1	2	3	4	5=2+3+4	6	7	8	9
2013	1.0	1,350,052.6	1,793.9	1,648.9	1,353,495.5	1.9	-0.4	49.9	16.4
2014	1.8	1,395,304.6	1,224.9	-17,930.9	1,378,598.7	0.7	-0.5	50.5	17.9
2015	2.2	1,427,799.0	3,405.4	-17,189.6	1,414,014.8	2.0	-2.1	52.9	17.5
2016						2.2	-1.5	55.9	15.6

Burimi: INSTAT.

Source: INSTAT.

3. BILANCI I PAGESAVE, REZERVA DHE KURSI I KËMBIMIT

BALANCE OF PAYMENTS, RESERVES AND EXCHANGE RATE 3.

Në milionë euro, përveç rasteve kur shënohet ndryshe

In millions EUR, unless otherwise indicated

	Bilanci i llogarisë korrente / Current account	Nga të cilat: Bilanci tregtar / Of which:Trade balance (3-4)			Nga të cilat: Remitancat / Of which: Remittances	Investimet direkte neto / Direct investments, net	Rezervat valutore (stok)/ Reserves (stock)	Rezervat në muaj importe / Reserves in months of import	Kursi i këmbimit / Exchange rate	
									Mesatare e periudhës / Period average	
			Eksporti / Export	Importi / Import					ALL / EUR	ALL / USD
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2013	-1,049.1	-1,979.3	1,050.6	3,029.9	543.8	-923.2	2,015.3	5.4	140.3	105.7
2014	-1,287.2	-2,215.6	931.7	3,147.3	591.9	-811.5	2,191.7	5.6	140.0	105.5
2015	-1,104.6	-2,298.9	771.1	3,070.1	597.1	-818.4	2,880.0	7.6	139.7	126.0
2016	-1,029.9	-2,602.8	713.7	3,316.5	614.5	-958.3	2,945.0	7.2	137.4	124.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

4. BILANCI FISKAL, STOKU I BORXHIT TË BRENDSHËM DHE BORXHI I JASHTËM

FISCAL BALANCE, DOMESTIC DEBT STOCK AND EXTERNAL DEBT 4.

Në miliardë lekë

In billions ALL

	Të Ardhura / Revenue	Nga të cilat: Të ardhura tatimore /Of which: Tax revenue	Shpenzime / Expenditure	Shpenzime kapitale / Capital expenditure	Deficiti / Deficit	Financim i brendshëm / Domestic financing	Financim i huaj / Foreign financing	Stoku i borxhit të Qeverisë Qendrore / Central government debt stock	
								Stoku i borxhit të brendshëm / Domestic debt stock	Stoku i borxhit të jashtëm / External debt stock
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2013	327.2	299.9	394.1	65.5	-66.9	56.1	10.8	520.8	363.9
2014	366.7	335.9	438.8	60.7	-72.1	42.2	29.9	564.7	412.4
2015	379.2	342.3	437.4	63.1	-58.2	-6.4	64.6	551.4	490.9
2016	407.0	369.9	433.7	59.5	-26.7	9.2	17.5	561.1	504.6

Burimi: Ministria e Financave, sipas publikimeve "Statistikat fiskale mujore, viti 2017" dhe Treguesit e Borxhit, 6 mujori I 2017".
Publikimi 'Statistika fiskale Janar - Qershor 2017' tabelat:
Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (Vjetor).
Shënime:
1) Përditësuar të dhënat për Dhjetor 2015 sipas ESA 2010.
2) Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë.
3) Përfaqëson kredinë për ekonominë.
4) Norma mesatare e ponderuar vjetore e depozitave dhe huave të reja 12 mujore në lekë për sistemin bankar.
5) Të dhënat i referohen normës në fund të periudhës.
6) Të dhënat sipas INSTAT: Llogaritë Kombëtare Vjetore; Llogaritë Kombëtare Vjetore (Metoda e prodhimit), sipas NVE Rev 2 (tabela 1); Llogaritë Kombëtare Vjetore (Metoda e Shpenzimeve) (tabela GNI); 2014 Finale; 2015 Gjysëm finale.
7) Të dhënat sipas informacionit në faqen e internetit të INSTAT datë 04.08.2017:
Temat/ Tregu i punës/ Anketa e Forcave të Punës/ Vjetore/ Shkalla e punësimit 2007-2016 (grupmosha 15-64 vjeç); Shkalla e papunësisë 2007-2016 (grupmosha 15-64 vjeç).

Source: Ministry of Finance, according to "Fiscal statistics monthly, year 2017 and "Debt Indicators, as of June 30, 2017" publications.
Publication 'Fiscal statistics January - Qershor 2017' table:
Consolidated general budget (Annual).
Footnote:
1) Revised the data of December 2015 according to ESA 2010.
2) Deposits included in broad money.
3) Credit to economy.
4) The annual weighted average rate of the 12 months new deposits and loans in ALL for the banking system.
5) End of period data.
6) The data as of INSTAT: Annual National Accounts , Annual National Accounts (Production Method), by NACE Rev 2 (table 1); Annual National Accounts (Expenditure Method) (GNI table); 2014 Final; 2015 Semi final.
7) Data as of INSTAT web page tables, date 04.08.2017:
Figures/ Figures by theme/ Labour market/ Labour Force Survey/ Yearly/ Employment rate 2007-2016 (age group 15-64 years): Unemployment rate 2007-2016 (age group 15-64 years).

1 SEKTORI FINANCIAR
1-1 BILANCI SEKTORIAL I BANKËS SË SHQIPËRISË
Në milionë lekë, fund periudhe

FINANCIAL SECTOR 1
SECTORAL BALANCE SHEET OF BANK OF ALBANIA 1-1
In millions ALL, end of period

	Totali i mjeteve / Total assets (2+ 3+ 4+ 5+ 8+ 12+ 13+ 14)	Ari monetar dhe mbajtjet e SDR*/ Monetary gold and SDR holdings*	Arka në valutë / Foreign currency	Depozita**/ Deposits**	Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet / Securities other than shares (6+7)			Huatë / Loans (9+10+11)				Derivatet financiare / Financial derivatives	Llogari të arkëtueshme / Receivable accounts	Mjete jofinanciare**/ Nonfinancial assets**
						Jorezidentë / Nonresidents	Qeveria Qendrore / Central Government		Qeveria Qendrore / Central Government	Korporata të tjera depozituese / Other depository corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
2014/12	433,878.0	19,299.7	56.2	32,524.0	320,744.6	256,796.7	63,947.9	27,286.3	_	25,547.8	1,738.5	17.4	18,197.8	15,752.1
2015/12	516,357.9	30,578.8	84.9	93,147.1	323,679.0	270,453.6	53,225.5	14,641.1	_	12,987.1	1,654.0	27.7	32,741.6	21,457.8
2016/12	524,730.8	27,211.8	52.0	104,622.9	315,112.7	261,877.5	53,235.2	31,660.3	_	29,934.4	1,725.9	15.8	25,094.1	20,961.2
2017/01	511,197.8	25,003.0	27.1	96,900.5	307,742.1	254,698.0	53,044.0	35,672.4	_	33,947.4	1,725.0	15.7	24,917.2	20,919.9
02	510,119.1	34,992.5	145.1	94,289.2	305,361.0	252,842.0	52,518.9	30,000.8	_	28,282.5	1,718.3	16.7	24,434.6	20,879.3
03	524,770.3	33,472.7	35.2	109,795.4	306,607.8	254,116.5	52,491.3	28,111.5	_	26,382.8	1,728.7	16.4	25,891.7	20,839.8
04	502,822.2	31,766.6	24.0	97,122.5	293,834.8	242,011.6	51,823.2	34,828.0	_	33,098.3	1,729.7	15.8	24,405.2	20,825.5
05	500,118.6	30,861.4	18.3	94,098.8	296,398.1	243,204.8	53,193.3	34,111.5	_	32,380.8	1,730.7	14.8	23,831.2	20,784.6
06	500,249.4	29,967.5	24.4	108,552.9	283,824.6	230,549.7	53,274.8	32,845.7	_	31,121.0	1,724.6	13.5	24,274.4	20,746.6

	Detyrimet totale / Total liabilities (2+ 3+ 4+ 10+ 14+ 15+16)	Paraja në qarkullim / Currency in circulation	Depozita të përfshira në paranë e gjerë / Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë / Deposits excluded from broad money (5+6+7+8+9)						Huatë / Loans (11+ 12+13)				Llogari të pagueshme / Other accounts payable	Alokimi i SDR / SDR allocation	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit / Shares and other equity
					Jorezidentët / Nonresidents	Qeveria Qendrore / Central Government	Korporata të tjera depozituese / Other depository corporations	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors		Jorezidentët / Nonresidents	Qeveria Qendrore / Central Government	Korporata të tjera depozituese / Other depository corporations			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2014/12	433,878.0	226,434.1	154.2	140,569.3	16,564.1	16,600.5	106,310.9	85.0	1,008.8	2,294.2	2,294.2	_	_	889.8	7,753.2	55,783.2
2015/12	516,357.9	239,218.1	1,787.9	201,585.6	31,826.2	26,340.8	142,966.8	87.4	364.4	1,809.6	1,809.6	_	_	461.3	8,104.4	63,391.1
2016/12	524,730.8	258,848.0	3,183.2	191,379.7	19,860.9	18,975.1	152,349.7	72.1	121.9	314.2	314.2	_	_	1,164.6	7,981.2	61,859.9
2017/01	511,197.8	256,854.9	3,082.8	178,188.3	19,797.8	29,811.6	128,383.6	73.3	121.9	273.9	273.9	_	_	1,256.9	8,018.1	63,523.0
02	510,119.1	254,979.4	4,139.8	179,334.5	19,780.0	40,545.4	118,814.9	72.5	121.7	231.1	231.1	_	_	483.1	8,010.4	62,940.8
03	524,770.3	254,232.6	1,830.1	194,749.6	19,757.2	37,889.2	136,914.4	72.9	116.0	232.3	232.3	_	_	1,680.6	8,048.2	63,996.8
04	502,822.2	256,339.8	4,840.4	173,991.9	19,750.7	38,164.6	115,894.6	72.3	109.6	206.6	206.6	_	_	569.0	7,864.3	59,010.3
05	500,118.6	257,230.8	4,181.0	174,975.2	19,450.7	37,138.8	118,213.5	71.9	100.3	201.9	201.9	_	_	872.0	7,698.3	54,959.4
06	500,249.4	261,236.4	3,480.6	177,643.2	19,431.3	34,113.7	123,930.5	71.3	96.4	197.3	197.3	_	_	781.4	7,519.4	49,391.2

Burimi: Banka e Shqipërisë
** Për periudhën Dhjetor 2002-Prill 2014 është bërë riklasifikimi i arit monetar nga zëri "Depozita" në zërin "Ari monetar dhe mbajtjet e SDR".*
*** Për periudhën Dhjetor 2015-Prill 2016 është bërë riklasifikim i arit jo monetar nga zëri "Depozita" në zërin "Mjete jo financiare".*

Source: Bank of Albania.
** The data of December 2002-April 2014 reflect a reclassification of monetary gold from "Deposits " to " Monetary gold and SDR holdings".*
*** The data of December 2015-April 2016 reflect a reclassification of non-monetary gold from "Deposits "to " Non-financial assets".*

1-2 PARAQITJA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË
Në milionë lekë, fund periudhe

MONETARY SURVEY OF BANK OF ALBANIA 1-2
In millions ALL, end of period

	Mjete valutore neto*/ Net foreign assets* (2-3)	Pretendime ndaj jorezidentëve/ Claims on nonresidents	Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve / Less: Liabilities to nonresidents	Mjetet e brendshme / Domestic assets (5+ 8+ 9+ 10+ 11+ 12)	Pretendime neto ndaj Qeverisë Qendrore / Net claims on Central Government (6-7)	Pretendime ndaj Qeverisë Qendrore / Claims on Central Government	Minus: Detyrime ndaj Qeverisë Qendrore / Less:Liabilities to Central Government	Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese / Claims on other depository corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare / Claims on other financial corporations	Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike / Claims on public nonfinancial corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare / Claims on other nonfinancial corporations	Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë / Claims on other resident sectors
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
2014/12	292,098.3	318,940.2	26,841.9	82,525.1	55,198.3	71,831.3	16,633.0	25,547.8	_	_	37.3	1,741.7
2015/12	363,088.0	405,079.5	41,991.5	63,394.2	48,752.0	75,143.9	26,391.9	12,987.1	_	_	_	1,655.1
2016/12	389,612.7	418,562.1	28,949.4	65,915.7	34,255.6	53,279.9	19,024.3	29,934.4	_	_	_	1,725.7
2017/01	372,032.3	401,162.8	29,130.5	58,977.5	23,305.0	53,157.7	29,852.7	33,947.4	_	_	_	1,725.1
02	377,986.6	406,288.9	28,302.3	42,092.5	12,091.1	52,670.0	40,578.8	28,282.5	_	_	_	1,718.9
03	393,476.1	422,972.2	29,496.1	42,754.8	14,642.4	52,562.9	37,920.5	26,382.8	_	_	_	1,729.6
04	366,790.3	394,958.3	28,168.0	48,554.3	13,724.4	51,933.1	38,208.7	33,098.3	_	_	_	1,731.6
05	363,708.8	391,709.3	28,000.5	50,181.9	16,068.2	53,239.9	37,171.7	32,380.8	_	_	_	1,732.9
06	365,358.2	393,027.9	27,669.7	52,059.2	19,212.2	53,371.5	34,159.3	31,121.0	_	_	_	1,725.9

	Baza monetare / Monetary base (14+ 15+ 16)	Paraja në qarkullim / Currency in circulation	Detyrime ndaj korporatave të tjera depozituese / Liabilities to other depository corporations	Depozita të përfshira në paranë e gjerë / Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë / Deposits excluded from broad money	Huatë / Loans	Llogari të pagueshme / Other accounts payable	Të tjera neto / Other items net	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit / Shares and other equity
	13	14	15	16	17	18	19	20	21
2014/12	332,899.3	226,434.1	106,310.9	154.2	1,093.8	_	14.8	-15,167.6	55,783.2
2015/12	383,972.8	239,218.1	142,966.8	1,787.9	451.8	_	34.2	-21,367.7	63,391.1
2016/12	414,380.9	258,848.0	152,349.7	3,183.2	194.0	_	47.2	-20,953.6	61,859.9
2017/01	388,321.4	256,854.9	128,383.6	3,082.8	195.1	_	14.0	-21,043.7	63,523.0
02	377,934.1	254,979.4	118,814.9	4,139.8	194.2	_	13.8	-21,003.8	62,940.8
03	392,977.2	254,232.6	136,914.4	1,830.1	188.8	_	35.7	-20,967.7	63,996.8
04	377,074.8	256,339.8	115,894.6	4,840.4	182.0	_	21.3	-20,943.7	59,010.3
05	379,625.3	257,230.8	118,213.5	4,181.0	172.2	_	44.0	-20,910.1	54,959.4
06	388,647.4	261,236.4	123,930.5	3,480.6	167.7	_	70.0	-20,858.8	49,391.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.
** Për periudhën Dhjetor 2015-Prill 2016 është bërë riklasifikim i arit jo monetar nga zëri "Depozita" në zërin "Mjete jo financiare".*

Source: Bank of Albania.
** The data of December 2015-April 2016 reflect a reclassification of non-monetary gold from "Deposits "to " Non-financial assets".*

1-3.A BILANCI SEKTORIAL I BANKAVE PARADEPOZITUESE/ MJETET

Në milionë lekë, fund periudhe

SECTORAL BALANCE SHEET OF DEPOSIT MONEY BANKS/ ASSETS 1-3.A

In millions ALL, end of period

	Totali i mjeteve / Total assets (2+ 3+ 4+ 8+ 12+ 22+ 25+ 26+ 27)	Arka në lekë / National currency	Arka në valutë / Foreign currency	Depozita / Deposits (5+ 6+ 7)				Letra me vlerë të ndryshme nga aksionet / Securities others than shares (9+ 10+ 11)				Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations
					Jorezidentët / Nonresidents	Banka Qendrore / Central Bank	Bankat paradepozituese / Deposit money banks		Nga të cilat / of which:	Jorezidentët / Nonresidents	Qeveria Qendrore/Central Government	
	1	2	3	4	5	6	7	8		9	10	11
2014/12	1,354,708.0	8,765.4	11,055.4	245,965.9	130,183.8	106,632.0	9,150.1	424,283.6		87,349.5	336,934.2	_
2015/12	1,365,627.6	8,610.0	10,650.1	301,970.9	147,563.2	144,219.2	10,188.5	378,356.7		64,927.3	313,429.5	_
2016/12	1,446,048.9	9,424.8	13,685.4	302,582.2	140,174.5	151,994.3	10,413.5	426,178.2		92,042.1	333,995.3	140.7
2017/01	1,454,785.2	10,470.3	13,562.3	311,662.7	173,164.5	128,025.8	10,472.5	424,029.0		85,241.2	338,667.0	120.8
02	1,441,451.6	10,395.0	13,351.8	302,667.6	173,493.0	120,714.7	8,459.9	415,541.1		76,081.4	339,389.1	70.6
03	1,441,619.1	9,666.6	13,263.3	304,627.1	156,987.4	139,493.1	8,146.6	412,646.5		72,390.2	340,185.5	70.8
04	1,438,039.4	9,885.7	13,598.3	301,518.1	176,556.4	117,976.3	6,985.4	417,905.8		76,346.4	341,488.5	71.0
05	1,430,521.5	10,492.0	14,357.4	296,514.6	169,133.9	118,434.7	8,946.0	419,267.7		78,797.6	340,398.8	71.2
06	1,423,682.4	10,673.4	13,989.6	298,000.6	163,180.2	128,263.9	6,556.5	408,266.9		67,720.4	340,546.5	_

	Huatë / Loans (13+ 14+ 15+ 16+ 17+ 18+ 19+ 20+ 21)	Jorezidentët / Nonresidents	Banka Qendrore / Central Bank	Bankat paradepozituese / Deposit money banks	Korporata të tjera financiare / Other financial corporations	Qeveria Qendrore / Central Government	Qeveria lokale / Local government	Korporata jofinanciare publike / Public nonfinancial corporations	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit / Shares and other equity (23+24)	Jorezidentët / Nonresidents	Rezidentë / Residents	Derivatet financiare / Financial derivatives	Llogari të Arkëtueshme / Other accounts receivable	Mjete jofinanciare / Nonfinancial assets
	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27
2014/12	614,230.0	53,447.7	_	6,011.6	8,270.3	1,263.2	777.7	27,328.2	372,166.6	144,964.8	5,858.9	5,020.0	838.9	_	7,551.9	36,997.0
2015/12	613,283.4	68,177.5	_	3,700.1	9,537.7	1,099.5	887.7	27,500.5	346,210.1	156,170.4	7,223.3	6,529.9	693.4	_	8,114.2	37,418.9
2016/12	637,885.3	94,431.0	_	2,561.2	8,687.6	947.5	845.5	26,863.9	343,070.3	160,478.3	8,023.0	7,192.2	830.8	_	8,886.8	39,383.1
2017/01	638,736.2	98,241.4	_	1,548.8	9,113.6	958.0	838.3	26,880.1	340,254.3	160,901.8	8,155.2	7,323.0	832.2	_	8,732.8	39,436.7
02	643,141.4	101,912.3	_	1,721.3	9,058.6	947.0	834.1	26,943.5	341,042.8	160,682.0	8,249.3	7,418.7	830.6	_	9,098.7	39,006.8
03	645,025.9	101,007.8	_	2,880.9	9,168.2	954.5	816.5	27,197.4	340,846.6	162,154.0	8,053.0	7,221.1	831.9	_	8,675.3	39,661.6
04	638,835.9	96,482.1	_	3,860.6	8,932.4	811.5	815.3	27,542.7	338,225.4	162,165.9	7,755.8	6,925.2	830.6	_	9,223.7	39,316.0
05	634,144.9	94,912.2	_	1,600.8	8,642.8	805.3	812.4	27,795.4	335,618.8	163,957.3	7,681.1	6,851.5	829.6	_	8,990.9	39,073.1
06	636,190.1	97,335.4	_	2,180.5	8,595.9	796.3	809.5	28,831.5	333,122.6	164,518.5	7,726.9	6,850.7	876.2	_	8,722.9	40,112.0

1-3.B BILANCI SEKTORIAL I BANKAVE PARADEPOZITUESE/ DETYRIMET

Në milionë lekë, fund periudhe

SECTORAL BALANCE SHEET OF DEPOSIT MONEY BANKS/ LIABILITIES 1-3.B

In millions ALL, end of period

	Detyrimet totale / Total liabilities (2+ 8+ 17+ 20+ 29+ 30)	Depozita të përfshira në paranë e gjerë / Deposits included in broad money (3+ 4+ 5+ 6+ 7)						Depozita të papërfshira në paranë e gjerë / Deposits not included in broad money (9+ 10+ 11+ 12+ 13+ 14+ 15+ 16)								
			Korporata të tjera financiare / Other financial corporations	Qeveria lokale / Local Governments	Korporata jofinanciare publike / Public nonfinancial corporations	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors		Jorezidentët / Nonresidents	Banka Qendrore / Central Bank	Korporata të tjera depozituese / Other depository corporations	Qeveria Qendrore / Central Government	Korporata të tjera financiare / Other financial corporations	Korporata jofinanciare publike / Public nonfinancial corporations	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2014/12	1,354,708.0	973,776.8	8,398.5	2,286.6	18,067.0	105,804.8	839,219.9	97,149.3	23,988.8	1,014.8	13,793.7	4,203.4	64.5	83.1	7,828.6	46,172.6
2015/12	1,365,627.6	980,027.7	12,861.5	1,713.2	14,537.7	113,245.2	837,670.1	112,215.7	16,693.7	1,892.8	11,914.9	6,749.8	1,136.9	285.7	7,853.9	65,688.1
2016/12	1,446,048.9	1,005,978.9	11,997.6	2,292.5	13,154.1	136,885.4	841,649.4	138,410.1	14,902.5	356.2	13,771.4	9,277.4	938.9	338.3	8,106.7	90,718.7
2017/01	1,454,785.2	1,005,930.2	12,340.3	2,041.6	13,105.5	137,419.6	841,023.2	142,749.8	17,264.6	275.9	14,371.5	8,336.0	987.5	319.8	8,907.8	92,286.8
02	1,441,451.6	994,715.2	11,514.5	1,883.8	12,735.4	135,044.0	833,537.5	144,876.7	14,731.8	2,564.3	14,143.6	8,761.5	998.1	277.5	8,630.5	94,769.5
03	1,441,619.1	991,723.9	12,223.8	2,048.1	12,259.1	130,861.6	834,331.3	149,721.9	15,708.3	2,868.4	15,641.4	9,719.0	861.8	265.6	8,561.0	96,096.6
04	1,438,039.4	989,694.8	12,278.5	2,117.3	12,372.1	133,126.6	829,800.3	145,867.4	15,249.8	989.8	13,474.2	9,569.5	595.0	267.5	8,536.9	97,184.8
05	1,430,521.5	985,567.2	12,564.3	1,393.0	12,723.5	134,560.2	824,326.2	148,481.1	18,076.3	498.9	12,219.5	10,710.5	1,018.8	267.7	8,257.0	97,432.4
06	1,423,682.4	979,941.2	12,634.0	1,275.0	11,940.6	135,877.8	818,213.9	149,010.9	14,436.7	4,727.0	10,904.9	10,253.5	1,007.4	281.1	7,779.1	99,621.1

	Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet (18+ 19)			Huatë / Loans (21+ 22+ 23+ 24+ 25+ 26+ 27+ 28)									Llogari të pagueshme / Other accounts payable	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit / Shares and other equity
